

Zehrie Plakolli

# EDUKIMI ESTETIK I NXËNËSVE DHE LETËRSIA PËR FËMIJË



Prishtinë  
2015



Zehrie Plakolli

**EDUKIMI ESTETIK I NXËNËSVE DHE  
LETËRSIA PËR FËMIJË**

**Prishtinë, 2015**

**Botues:**

Instituti Pedagogjik i Kosovës

**Për botuesin:**

M. Sc. Ismet Potera

**Autor:**

Zehrie Plakolli

**Recenzentë:**

1. Qibrie Demiri
2. Sala Ahmetaj-Çitaku

**Lektor:**

Mirjeta Gashi

**Përgatitja teknike:**

Skender Mekolli

## **Përmbajtja**

I.	Hyrje .....	5
	Nocioni “Estetikë” .....	6
II.	DIMENSIONI UNIVERSAL I EDUKIMIT ESTETIK.....	7
	2.1. Universaliteti i edukimit estetik .....	7
	2.2. Edukimi estetik, si rritje e pasionit për të bukurën .....	11
III.	LETËRSIA PËR FËMIJË, SI PASION DHE SI MISION ....	16
	3.1. Veçori të përgjithshme të letërsisë për fëmijë .....	16
	3.2. Letërsia si përçues idesh nga të rriturit, tek fëmijët.....	20
	3.3. Karakteri social i Letërsisë për fëmijë dhe estetika e saj .....	22
	3.4. Letërsia për fëmijë, në funksion të ndërgjegjësimit patriotik – estetika patriotike .....	25
	3.5. Karakteri moral, etik dhe didaktik i Letërsisë për fëmijë .....	29
IV.	LETËRSIA DHE FORMIMI ESTETIK I NXËNËSVE NË SHKOLLË .....	35
	4.1. Estetika në procesin edukativ-mësimor.....	35
	4.2. Letërsia në shkollë, domosdoshmëri estetike dhe didaktike .....	37
	4.3. Faktorët që ndikojnë në performancën e letërsisë në shkollë.....	40

4.3.1. Mësimdhënia e letërsisë.....	42
4.3.2. Teksti shkollor i letërsisë.....	49
4.3.3. Lektyra shkollore.....	53
V. PËRFUNDIM.....	60
VI. Bibliografia .....	64
VII. Literatura: .....	66

## I. Hyrje

Objektivë esenciale e këtij punimi është rëndësia e edukimit estetik në përgjithësi dhe e Letërsisë për fëmijë në veçanti, në formimin e personalitetit më të plotë e më të gjithanshëm të fëmijës. Në kuadër të kësaj çështjeje, në këtë punim, përveç veçantive të përgjithshme të edukimit estetik dhe Letërsisë për fëmijë, në mënyrë specifike janë prekur paksa edhe çështjet si: - Mësimdhënia e letërsisë, -Teksti shkollor i letërsisë dhe -Lektyra shkollore. Pra, në fokus të kësaj problematike, është dhënë, rëndësia e pakontestueshme e estetikës në përgjithësi dhe e artistikes në veçanti, e posaçërisht rëndësia e edukimit estetik i cili ka ndikim të gjithanshëm në personalitetin e njeriut e sidomos në formimin më të plotë të personalitetit të fëmijës-nxënësit. Arsyeja e përcaktimit për këtë çështje studimi, është fakti se edukimi estetik, si edukim universal, është i nevojshëm në çdo kohë dhe në çdo aspekt të jetës njerëzore. Ky është një proces specifik e i ndërlikuar i edukimit, që në mënyrë spontane, bëhet gjatë tërë jetës në familje, në atë që i ofron rrethi shoqëror, për të vazhduar në mënyrë të planifikuar e të organizuar nëpër mes të institucioneve edukativo-arsimore. Prandaj, pjesë thelbësore e edukimit të përgjithshëm dhe synim i çdo sistemi arsimor është edhe edukimi estetik, i cili realizohet në shkollë si komponentë e veçantë e tij (përmes lëndëve të caktuara si: Edukatë muzikore, Edukatë qytetare, Art figurativ, Edukatë fizike , Letërsi e gjuhë shqipe, etj ). Edukimi në vete përmban si objektivë krijimin e idesë, shijes, dëshirës dhe vullnetit të nxënësit për të bukurën në art, në punë e në jetë, pastaj aftësimin e tij për ta vërejtur, për ta përjetuar, vlerësuar, kultivuar dhe, krahas këtyre, edhe për ta krijuar ai vetë të bukurën.

Fjalët kyçe: Edukimi, estetika, artistikja, letërsia, fëmija, nxënësi, personaliteti, shkolla.

### **Nocioni “Estetikë”**

Estetika si nocion për herë të parë është paraqitur në gjysmën shekullit XVIII (nga Baumgarteni). Kjo fjalë, nga greqishtja përkthehet si ndijim, si perceptim i së bukurës. Për dallim nga të njohurit racional (gnoseologjik), estetika është shkencë për të njohurit sensual, emocional (sipas Kantit, estetika është kritika e shijes artistike). Koncepti estetikë rrjedh nga koncepti i shijes dhe lidhet me të. Estetika është degë e filozofisë, që merret me të bukurën në natyrë, në art dhe me shijen për artin. Merret me krijimin dhe vlerësimin (grykimin) për të bukurën (objektive e subjektive). Estetika është e definuar edhe si studim mbi ndijimin, mbi vlerat emocionale dhe si grykim i ndjenjës, sentimentit e shijes. Teoria më specifike e estetikës, ka të bëjë me degë të caktuara të artit dhe ndahet në fusha të ndryshme të estetikës së arteve si; estetika e muzikës, e pikturës, e letërsisë, etj.



## **II. DIMENSIONI UNIVERSAL I EDUKIMIT ESTETIK**

### **2.1. Universaliteti i edukimit estetik**

E bukura është një fenomenologji e shpirtit, e cila ka efekt pothuajse vetëm shpirtëror. E fenomenet e natyrës shpirtërore, janë të përhershme dhe universale. Është në natyrën e njeriut dhe brenda proceseve të tij të përditshme, komunikimi me të bukurën në jetë, në punë, në natyrë, në ambiente që e rrethojnë, në dukje, në ushqim e në çdo specifikë jetësore. Përveç fenomeneve artistike që ka i krijuar natyra, si: tingujt, aromat, ngjyrat, peizazhet, detin, diellin, agimin, muzgun, një botë e tërë veprimtarishë, janë edhe artet e krijuara, në të cilën përfshihen: letërsia, muzika, teatri, filmi, arkitektura, piktura, skulptura, etj. Ndër veprimtaritë kryesore, kulturore, është arti, i cili i rrit vlerat njerëzore të një shoqërie. Akti i kuptimësimit të artit, ose të bukurës, është perceptimi emocional i tij. Emocionet, ndjenjat që shkakton estetikja, janë reflektim i artit, si “pasojë” e artit, e cila mund të jetë ndjenjë e mirë, e keqe, e gëzimit, e ngazëllimit, e dëshpërimit apo e trishtimit, varësisht nga përmbajtja e vlerës estetike. Estetika, si shkencë mbi të bukurën, mbi artistiken, si shkencë mbi ligjshmëritë e trajtimit estetik, i ka kategoritë e veta, siç janë: e bukura, e shëmtuara, tragjikja, komikja, e larta, e madhërishmja, simpatikja, simetrikja, asimetrikja, etj. Përjetimi i këtyre fenomeneve emocionale, u ndodh vetëm atyre që e kanë të

kultivuar shijen estetike për të përjetuar një vlerë estetike. Sipas Shilerit, “Çelësi i edukimit në përgjithësi është edukimi për të bukurën” ( Fridrih Shiler, “Mbi edukimin estetik të njeriut”, Tiranë, 2004, f. 86). Kurse shumë më herët, Aristoteli thotë: „Edukimi i mendjes pa edukimin e zemrës, nuk është edukim,,

Edukimi estetik, realizohet në mënyra të ndryshme, kurse në këtë kontekst, flasim për edukimin estetik në shkollë, i cili realizohet përmes lëndëve specifike mësimore, e veçanërisht përmes letërsisë, e cila është objektive e këtij studimi. Duke ua zhvilluar nxënësve ndjenjën për ta vërejtur, e për ta përjetuar të bukurën në art, në natyrë e në jetë përgjithësisht, edukimi estetik, së bashku me fushat e tjera edukative arsimore, intelektuale e morale, përbën një tërësi unike të edukimit, që ka për qëllim, formimin e gjithanshëm të njeriut të ri, nxënësin. Edukimi estetik, përshkon tërësinë e personalitetit të nxënësit dhe reflekton në të gjitha performancat e tij shkollore e jetësore. Ai ndikon në raportin e tij me artistiken, por edhe në raportin e tij me njerëz dhe me mënyrën e përgjithshme të jetesës së tij. Pra, edukimi estetik, përveç ndikimit në zhvillimin emocional, ushtron ndikim edhe në zhvillimin intelektual të njeriut e në këtë kontekst të nxënësit, duke ndikuar në thellimin e njohjes së realitetit, në begatimin e përjetimeve, kështu që ndikon në plotësimin e personalitetit të tij. Edukimi estetik, është i lidhur ngushtë me edukimin intelektual të nxënësve, sepse në procesin e edukimit estetik, aktivizohet një numër i madh funksionesh intelektuale, të cilat zhvillohen fuqimisht në këtë proces; përsosen aftësitë e të analizuarit, të të vërejturit, të kujtesës, të riprodhimit të imazheve, të fantazisë krijuese, kështu që, krijohen aftësi të të menduarit. “Njohuritë me karakter estetik, janë të pazëvendësueshme me njohuri të

natyrave të tjera, si; shkencore, filozofike apo sociale. Njohja jonë e jetës, e plotësuar me përjetime estetike, bëhet më e shumëllojshme dhe më e begatshme” (Grup autorësh, “Pedagogjia”, Zagreb, 1978, f. 195).

Në jetën njerëzore - shoqërore kudo, shfaqet nevoja për edukim estetik (në punë e në jetë). Nevojat për edukim estetik dhe për të mbushur jetën me vlera të tilla, janë individuale dhe shoqërore, duke i dhënë formë estetike edhe krijimtarisë, edhe punës, edhe dukjes, edhe formave të komunikimit përgjithësisht, etj. Nuk ka njeri me mendje normale, që nuk dëshiron të ketë jetën të mbushur me gjëra të bukura, si shpirtërore, ashtu edhe materiale. (Vetëm në shoqëritë e pazhvilluara - të varfra, nuk ka kuptim estetikja). Dikur, edukimi estetik, konsiderohej si një edukim që ka të bëjë jo me jetën përgjithësisht, por vetëm me fushën e veprimtarisë artistike dhe nuk konsiderohej e nevojshme që të edukohej e tërë shoqëria, me këtë lloj edukimi. Mirëpo, se shija për të bukurën, ka ekzistuar gjithnjë, argumentohet me të bukurat e mbijetuara, që nga antika, e ato janë të natyrave të ndryshme: arkitekturë, pikturë, skulpturë, vlera të trashëguara letrare, vlera artizanale etj. Pra, edhe në shoqëritë e mëhershme, edhe në ato bashkëkohore, edukimi estetik nuk është edukim plotësues, por një domosdoshmëri shoqërore, nevojë themelore e jetës së njeriut, e sipas pedagogjisë bashkëkohore është premisë themelore e edukimit. Figura shpirtërore dhe morale e njeriut të ri, nuk mund të kuptohet pa formimin e shijes së tij dhe ndjenjës për të bukurën në jetë dhe në punë. Këto, nuk mund të arrihen spontanisht, por vetëm përmes edukimit dhe “çelësi i edukimit është përjetimi i së bukurës”, që e bën të mundur mësimin e gjuhëve të artit, përmes ndërgjegjësimit për artin dhe artistiken..

Poetikja, e bukura, është edhe dhunti edhe kulturë, prandaj nevojat, kërkesat, tiparet dhe motivet themelore të njeriut në jetë, shndërrohen edhe në kërkesa estetike, të cilat janë si tipare burimore të qenies dhe njëkohësisht edhe si tipare të kultivuara kulturore, të njeriut. Pra, e bukura e jetës, estetikja, është si intencë, si efekt kulture dhe si vetëdije e njeriut. Poetikja, e bukura, estetikja buron nga njeriu, por edhe nga natyra në të cilën jeton njeriu dhe e rrethon atë, sado që kjo e dyta, nuk flet, nuk imponohet, nuk është intencionale (peizazhet, qielli, dielli, yjet, shiu, tingujt, ngjyrat dhe fenomenet tjera të natyrës), vetëm që duhet pasur shqisa, për t'i shijuar ato. E bukura dhe shijimi i saj, janë elemente fundamentale të njerëzshmërisë, e cila e prek së pari në emocion, pastaj në intelekt të njeriut. Edukimi estetik, është një domosdoshmëri jo vetëm për plotësimin shpirtëror të individit, por edhe për zhvillimin e harmonishëm e të qytetëruar të shoqërisë në përgjithësi. Ndër të arriturat fundamentale të një shoqërie, janë veprimtaritë kulturore dhe arti në veçanti, i cili ngre vlerat njerëzore të saj. Akti thelbësor i artit, është perceptimi emocional i gjithë larmisë së botës së tij, perceptimi i së bukurës, që mund t'u ndodhë vetëm atyre, që e kanë të kultivuar shijen estetike për të. Kurse, për krijuesin, vlerat estetike e përjetimi i tyre, mund të jenë edhe inspirim e frymëzim për krijim të artit estetik (që do të thotë arti e sjell artin). Ne, si qenie njerëzore, kemi nevojë që të ikim ndonjëherë nga realiteti, nga vrazhdësia e jetës, dhe t'i qasemi për ndonjë moment, fiksionit dhe imagjinatives. Jeta njerëzore, ka më shumë kuptim, nëse e ka të bukurën, artin, vlerën estetike, në çfarëdo aspekti qoftë ajo: në krijimtarinë artistike, në botën shpirtërore-emocionale, e në ambient jetësor përgjithësisht. Aftësia për të shijuar e për të

krijuar të bukurën, është veprimi më njerëzor, që më së shumti e dallon njeriun prej qenieve të tjera. Arti është i shumëllojshëm dhe aty nuk ka krahasim vlerash, sepse secili e ka rëndësinë e vet të veçantë. Arti matet vetëm përmes preferencave, shijes dhe përjetimit shumë subjektiv, unikat e individual. Ndër artet më të vjetra e më të rëndësishme dhe më me ndikim në edukimin e përgjithshëm, e në veçanti atë estetik, pa dyshim që është arti i fjalës. Letërsia, vlerën e saj, përjetshmërinë dhe universalitetin, e ka në performancën përmes fjalës dhe në lirinë e gjerësinë e trajtimit të saj, tematik-jetësor. Prandaj, edukimi estetik, konsiderohet si një edukim që ka të bëjë me jetën e kulturën njerëzore përgjithësisht dhe me fushën artistike në veçanti. Edukimi estetik, nuk është edukim profesional, vetëm për kategoritë artistike, por është edukim që lidhet ngushtë me çdo formë të punës e të jetës njerëzore. Interesimi për artin, edukimi estetik, nuk është shumë trashëgim, por kultivohet, zhvillohet e formohet sistematikisht dhe gradualisht. Ai duhet të nxitet që nga familja, në moshë të hershme, pastaj nga shkolla dhe institucione tjera të kësaj natyre, e deri te shoqëria, e cila patjetër duhet të ofrojë, ngado e kurdo, vlera estetike të të gjitha natyrave, në mënyrë që të jetë vetë një shoqëri e dinjitetshme, shpirtërisht më e fisnikëruar, emocionalisht, më e pasuruar dhe me kërkesa për të bukurën, më të avancuar.

## **2.2. Edukimi estetik, si rritje e pasionit për të bukurën**

Edukimi estetik, është koncept më i gjerë sesa koncepti edukim artistik. Ky i fundit është i kufizuar dhe ka të bëjë vetëm me të

bukurën në artin e krijuar, kurse edukimi estetik ka të bëjë me të bukurën përgjithësisht, në natyrë, në jetë, në cilëndo krijimtari njerëzore, fizike, mendore, morale, psikike, etj.

Për të kuptuar vlerën estetike, ose për të pasur shijen për të bukurën, duhet poseduar dhe kultivuar në vazhdimësi, një grup aftësish elementare: aftësinë për ta perceptuar, aftësinë për ta përjetuar, aftësinë për ta vlerësuar, si dhe aftësinë për ta krijuar atë. Këto përmbajnë nocionin e kuptimit të idesë, për të bukurën. Pa këto njohuri apo aftësi, njeriu, në këtë rast nxënësi, nuk ka as sy, as vesh, as emocion, as ide për të bukurën në natyrë, apo në jetë. Pranimi ose perceptimi i vlerës estetike letrare, apo vlerave estetike në përgjithësi, bëhet përmes intelektit, kurse përjetimi i artit bëhet vetëm përmes emocionit. Arti, është krijim i dedikuar vetëm për emocionin apo shpirtëroren dhe nuk posedon tjetër dobi (pa dashur të potencojmë çorientim dhe komercializim të tij, sepse është jashtë natyrës së këtij punimi). Edukimi estetik, realisht, ka të bëjë me “emancipimin”, edukimin emocional, dhe ky edukim, zhvillohet varësisht nga kushtet e jetës së individit, të familjes së tij dhe rrethit shoqëror. “Pa edukim estetik nuk mund të imagjinohet zhvillimi, formimi e vetëformimi i personalitetit të gjithanshëm të njeriut, e për këtë edhe duhet të trajtohet si pjesë shumë e rëndësishme e sistemit, procesit edukativo-pedagogjik” ( Dali Emërllahu, “Edukata Estetike”, Prishtinë, 2001, f. 14). Kjo komponentë edukimi, trajton raportin në mes të jetës dhe së bukurës, sepse, sipas Gjon Djuit, njeriu është një homo-estetikus. Çdo njeri, është pakëz artist dhe arti është një dimension i lindur i njeriut dhe vazhdimisht njerëzit, gjatë tërë etapave të tyre të zhvillimit, kanë treguar interesim për të bukurën. E bukura është

kriter qenësor i vlerësimit të raporteve njerëzore, i dukurive jetësore dhe natyrore, i „qenieve„ artistike dhe i krejt asaj që e rrethon njeriun. Do të thotë, e bukura dhe edukimi, për raportin e njeriut me to, janë nevoja dhe procese të zhvillimit individual e shoqëror. Nuk njohim dhe nuk ka shoqëri pa arte. Derisa s’ka shoqëri pa arte, do të thotë që, gjithnjë ka pasur interesim, përjetim dhe krijim të artit. Vlerat, përjetimet dhe krijimet estetike, nuk janë gjëra që maten, fiksohen në mënyrë konkrete, e as dëshmohen si argument i kapshëm. Për këtë, Aristoteli konsideronte që, estetika është jo shkencë mbi artin, por filozofi e artit dhe s’mund të ketë diçka më të saktë se kjo. Kurse, Sharl Lalo, te “Nocione të estetikës”, thotë: “...estetika është teoria mbi sensibilitetin dhe ndjeshmërinë”. Ndërsa, sipas Frojdit, “natyrën dhe origjinën e së bukurës, perceptimin, përjetimin dhe krijimin e saj, mund t’i shpjegojë në mënyrë të duhur vetëm psikanaliza. Arti është fenomen kulturor, shpirtëror dhe formë e përgjithshme e vetëdijes” ( Zigmund Frojd, “Mbi Letërsinë dhe artet” , ‘Fan Noli’, Tiranë, f. 14). „Arti ka karakter edhe filozofik, e psikologjik. Arti dhe filozofia janë dy forma të njohjes, vetëm se arti e trajton të veçantën, kurse filozofia e trajton të përgjithshmen, universalen” (Alfred Uçi, “Universi Estetik”, vëllimi III – Akademia e Shkencave Shqiptare,Tiranë, 2007, f. 25). Kurse, Kanti thotë se “e bukura buron nga emocioni dhe i dedikohet vetëm emocionit” (Immanuel Kanti, “KRITIKA E GJYKIMIT„ Plejadë, 2002, Tiranë), sado që estetika kantiane është shumë racionale dhe estetikën e studion vetëm nga aspekti i marrësit, i lexuesit, kur është fjala për letërsinë. Estetika ka të bëjë me artin, kurse arti ka të bëjë fundamentalisht me ndjenjat: me shpirtin, me emocionet, me ndijimet ndaj objekteve estetike, të cilat në procesin edukativ të

njeriut të ri (nxënësit), mund të shfrytëzohen edhe për ndonjë qëllim tjetër, edukativ, etik dhe moral. “Estetika, si degë dijesh mbi të bukurën, merret me problemin e fshehtësisë, të karakterit enigmatik, të thelbit të bukurisë në përgjithësi e të artit në veçanti” (Alfred Uçi, “Estetika I II III“, Tiranë, 1986, f. 13). Pastaj, sipas Alfred Uçit, “Estetika është disiplinë humanitare dhe trajton probleme edhe më të rëndësishme se disiplinat e tjera humanitare” (Alfred Uçi, “Estetika I II III“, Tiranë, 1986, f. 13 ) Sa më shumë që t’u injektosh njerëzve, e posaçërisht brezit të ri, artistiken, estetiken, do të thotë t’u ofrosh atyre qytetari (qytetërim), aq më shumë bëhen qytetarë të edukuar, më sublimë, më të ndjeshëm e më njerëzor, në çdo aspekt. Ndërgjegjja estetike, nënkupton edhe ndërgjegjen e përgjithshme humane, e që është nevojë e synim i çdo shoqërie. Edhe psiko-sociologët, kanë konstatuar se, me art edhe njerëzit më të ashpër e më të vrazhdë, bëhen më të ndjeshëm, më të butë, më pak egoistë, më pak narcisoid, ngase bota e artit, duke qenë një univers i vërtetë njohurish, përmban në vete lloj-lloj dukurish e njohurish, natyrore, shoqërore, intelektuale e emocionale. Por, në veçanti arti, përmban mjeshtri të komunikimit shpirtëror, që i dedikohet shpirtit, e kjo është pika më e ndjeshme dhe më me ndikim e njeriut. Për këtë, artin duhet shfrytëzuar, përveç si faktor që shkakton kënaqësi shpirtërore, edhe si mjet shumë të fuqishëm edukimi. Lidhur me këtë, me të drejtë, Shopenhaueri thotë që, „Vetëm ndjenjat për të bukurën, mund të neutralizojnë veset instiktive, negative të njerëzve,, . Ndërkaq, sipas De Radës, „E bukura është burim i të gjitha gjërave pozitive,, dhe të bukurën e klasifikon në: e bukura sublime, e bukura morale, e bukura formale, e bukura absolute. Sipas idesë së tij për estetikën, jeta



duhet të rregullohet e të organizohet përmes parimit të së bukurës: **“E bukura si parim suprem i shoqërisë”** (Ibrahim Rugova, “Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983”, Prishtinë, 1983, f. 36).

Kështu që çdo njeri, pavarësisht nga profesioni që zgjedhë në jetë, duhet të ketë pakëz shpirt, mendje dhe dorë të artistit, në mënyrë që ai të ketë vullnet për të bukurën, ta dojë ta çmojë e ta krijojë atë gjatë punës e jetës së tij.

### III. LETËRSIA PËR FËMIJË, SI PASION DHE SI MISION

#### 3.1. Veçori të përgjithshme të letërsisë për fëmijë

**“Ekziston e vërteta e pamohueshme që perspektiva e çdo shoqërie, varet para së gjithash, nga kujdesi i të rriturve ndaj brezit të ri, nga kompensimi i efekteve edukative, dhe kuptimi i drejtë i tyre, nga shkalla e dinjitetit që kanë të vegjlit në hierarkinë e përgjithshme shoqërore dhe përmasat që kemi në besimin ndaj tyre, duke e ditur që ata janë bartës të vazhdimësisë së jetës”.** (Agim Deva, “Poezia shqipe për fëmijë (1872-1980)”, “Rilindja”, Prishtinë, 1982, f. 7)

Letërsia për fëmijë, është krijimtari e veçantë, përmes së cilës synohet të ndikohet në edukimin dhe ngritjen intelektuale, shpirtërore e emocionale të fëmijës-nxënësit, përmes trajtimit të botës së tij dhe situatave të ndryshme konfliktuoze e provokuese që ofron vepra letrare. Letërsia për fëmijë, është njohuri-mjeshtri, e artikuluar artistikisht, e cila duhet të realizohet përmes disa veçorive, që janë: “Karakteret kryesore duhet të jenë fëmijët, tematikisht vepra duhet t’u përshtatet moshës dhe aftësive psikofizike të fëmijës, për moshat e vogla, vepra duhet të ketë më pak tekst e më shumë foto, të ketë më shumë dialog e më pak përshkrime (të cilat shkaktojnë monotoni te lexuesi fëmijë i vogël - citim yni), ndërtohet mbi heronjtë fëmijë që kanë përfundim kryesisht fatlum (si në përralla), të jetë letërsi që ka karakter njohës e edukativ, përveç atij estetik, përsëritjet e shpjegimet të

jenë të shpeshta për shkak të moshës së lexuesit, që ta përgatit fëmijët për jetën dhe situatat e ndryshme të saj”. ( Qibrie Demiri, “Letërsia për fëmijë”, “Rozafa”, Prishtinë, 2011 , f. 16)

Letërsinë shqipe për fëmijë, e karakterizon didaktizmi, moralizimi, prirjet pedagogjike-etike, por njëkohësisht e karakterizon edhe varfëria figurative gjuhësore, tautologjia metrike, strukturore (edhe pse dihet që forma nuk është performancë vetëm teknike, por pjesë e performancës së përgjithshme artistike), stilistika uniforme, simbolika e thjeshtë e deshifrueshme dhe e tërë kjo ndodh, të shumtën për shkak të moshës së lexuesit, të cilit i dedikohet (por mund të ndodhë edhe për shkak të kapaciteteve të kufizuara kreative) . Pra, arti letrar për fëmijë, zakonisht është i ngarkuar edhe me intencione të tjera jashtë letrare dhe jashtë botës së artit për fëmijë. Kështu që, veçanti e mangësi e letërsisë sonë për fëmijë, është paraqitja e varfër e botës psikologjike të fëmijës, pastaj mungesa e spontanitetit dhe natyrshmërisë fëmijërore në rrjedhjen e ngjarjes kreative, letrare. Këtu, mungon edhe loja si kuptim i botës fëmijërore. “Veprimtaria më e pëlqyer e fëmijës është loja dhe e kundërta e lojës së fëmijës është realiteti. Kujtimet e fëmijërisë, habitshëm ndikojnë në fantazinë e tyre, e kjo duhet pasur parasysh nga krijuesit e tyre, që fantazinë e tyre të dikurshme fëmijërore të lojës, ta zëvendësojnë, ta shndërrojnë në krijim për fëmijë, në mënyrë që autori të dijë të jetë si shok i fëmijës-lexues dhe si psikolog që di të mendojë, të ndjejë e të luajë me mendjen, me shpirtin dhe me mentalitetin e tij” (Zigmund Frojd, “Mbi letërsinë dhe artet”, “Fan Noli”, Tiranë, f. 12). Letërsia për fëmijë, duhet të jetë e pasur me fantazi, humor të lehtë, aventura, të ketë imagjinacion me befasi, në mënyrë që

leximi të bëhet më interesant dhe të zgjojë kureshtjen e fëmijës-nxënësit, si frymëzuese për lexim. Ndërkaq, në letërsinë tonë për fëmijë, zakonisht mbizotëron karakteri deklarativ, patetik e publicistik dhe jo shumë kreativ, i narracionit letrar për fëmijë.

Tematika e kësaj letërsie, sado që është e ngarkuar me moralizime, ideologji, didaktizëm etj., është mjaft e gjerë, por mungojnë temat konfliktuoze, që provokojnë kërshërinë e fëmijës. Mungojnë temat për adoleshentë, temat për të rinj, me problematikat familjare, shkollore e shoqërore. Pra, në Letërsinë tonë për fëmijë, janë të patrajuara çështjet e evoluimit, ndryshimit psiko-fizik të fëmijës, ndryshim i cili pason me një kompleksitet të tërë dilemash e situatash shpirtërore e emocionale, në raport me jetën dhe ndryshimet e kohës. Mungesë specifike në letërsinë tonë për fëmijë është, reflektimi i aspektit psikologjik të botës fëmijërore, (ndër të rrallët, vlen të theksohet si personazh i realizuar psikologjikisht, kryepersonazhi fëmijë, tek “**Kronikë në gurë**”, ku në mënyrë brilante, paraqitet bota e përjetimeve të fëmijës, në një situatë trans emocional, kur invadojnë armiqtë (italianët) në qytetin e tij). Pra, në këtë letërsi, mungon bota e ndjenjave më të thella të fëmijës dhe situatat delikate e dramatike. Një personazh që mbahet mend, i cili përjeton shqetësim të thelle shpirtëror dhe ngre tensionin e interesimit të lexuesit, është edhe Beni në librin “**Beni ecën vet**” të K. Blushit (i cili ballafaqohet me një situatë shumë tensionuese, psikike dhe emocionale. Ai përballlet me një moment dramatik dhe është para dilemës, të dorëzohet para një sfide që i shfaqet papritmas, derisa po shkonte me gomarin në mulli..., apo të vazhdonte më tutje duke rrezikuar).

Një element i veçantë e shumë i rëndësishëm për zhvillimin e letërsisë për fëmijë, është kritika letrare e saj, e cila, duke qenë si peshorja e matjes së vlerës artistike, në fakt e përcakton cilësinë dhe ecurinë e zhvillimit të saj të përgjithshëm. Ndërkaq, mund të themi që kritika e letërsisë sonë për fëmijë, është e pazhvilluar dhe joprofessionale. Kjo letërsi nuk vlerësohet as nuk kritikohet në baza të metodologjisë bashkëkohore të realizimit të saj si art, si bazë semantike, strukturore e psikanalitike. Nuk vlerësohen veçoritë stilistike të saj, por më shumë vlerësohet ana përmbajtjesore, e lidhur me mesazhin ose aludimin e saj. Kjo shpie në varfërimin e vlerës së mirëfilltë estetike të kësaj letërsie dhe në varfërim të efektit emocional, e estetik të saj. “Kritika si pjesë e shkencës mbi letërsinë, do të duhej të përcillte, të afirmonte në mënyrë të vazhdueshmet vlera të mirëfillta. Ajo do të duhej të ndikonte në ndryshimin e rrjedhave krijuese, në favor të vlerave të reja estetike në letërsinë për fëmijë., (Qibrie Demiri, “Letërsia për fëmijë”, “Rozafa”, Prishtinë, 2011, f. 83.) Kjo edhe do ta bënte më të efektshëm, raportin krijues-lexues ose libër–nxënës. Kështu, edhe do të afirmoheshin më shumë libri dhe fëmija-nxënësi i cili do të rritej bashkë me nevojën edhe dëshirën për lexim. Sepse kultura, shprehia e leximit, krijohet në fëmijëri, pak ka shanse që të fitohet në moshë të rritur.

Një vlerësim i tillë i Letërsisë për fëmijë, do të duhej të ishte më ndikuese e rekomanduese për krijuesit e saj. Sepse në fakt, mungon një kritikë e mirëfilltë e kësaj letërsie. Ajo që ekziston, më shumë është e aspektit informativ, e ndonjëherë nuk është adekuate dhe pak dallon, nga kritika e letërsisë për të rritur dhe e kanë të theksuar më shumë kriterin e historisë së letërsisë. (Ndër studiuesit e mirëfilltë të letërsisë për fëmijë është shkrimtari A.

Deva, me veprat **“Poezia shqipe për fëmijë”- 1872-1980** dhe **“Romani ynë për fëmijë”**, si dhe studiuesi i Shqipërisë, Astrit Beshqemi, me vëllimin **“Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë dhe të rinj”** dhe **“Historia e letërsisë shqipe për fëmijë”**. Pastaj, si studiues që vlen të përmenden janë edhe Bedri Dedja, Anton Berishaj, Milaim Nelaj, Ramadan Musliu, Xhevat Syla etj. ( Qibrie Demiri, “Letërsia për fëmijë”, “Rozafa”, Prishtinë, 2011, f. 83. )

### **3.2. Letërsia si përçues idesh nga të rriturit, tek fëmijët**

Letërsia shqipe për fëmijë, megjithëse nuk është e studiuar shumë, mendohet se fillimet i ka te një poezi tetëvargëshe e Lekë Matrëngës, që ishte brenda katekizmit të tij, “Doktrina e Krishterë” (1592), për t’u shfaqur pastaj tek pas dy shekujsh, me poezi të Naimit, të Naum Veqilharxhit, Konstantin Kristoforidhit dhe poezinë „Ylli i vogël lart në qiell”, në vitin 1872, e cila konsiderohet edhe si fillim i kësaj letërsie, për të vazhduar me “Alfabetare e gjuhës shqipe,, me autorë S. Frashërin, Th. Mitkon, Z. Jubanin e disa të tjerë, të botuar në Stamboll më 1879. “Letërsia popullore sado që është më e hershme dhe si shtyllë ose burim i rrjedhshëm i letërsisë së shkruar për një kohë të gjatë, nuk mund të konsiderohet si periudhë e parë e një letërsie të shkruar, sepse ajo edhe funksionon e zhvillohet vazhdimisht krahas asaj të shkruar”. (Agim Deva, “Poezia shqipe për fëmijë 1872-1980”, Rilindja, Prishtinë, 1982, f. 31) Më pastaj, zbrazësinë e letërsisë shqipe për fëmijë, e plotëson në një mënyrë Ezopi e La Fonteni, me fabulat e tyre, të cilat përshtaten e përkthehen për një kohë të

gjatë, e për të vazhduar ndikimin, për një kohë edhe më të gjatë. Pastaj, Naimi, Çajupi, Mjeda e të tjerë, këto fabula i modifikojnë, i rikonfigurojnë me idetë, qëllimet e nevojat e kohës. Pason letërsia për fëmijë e kohës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare, e cila, në bazë të mënyrës së krijimit; improvizimeve të ngutshme, përkthimit e përshtatjeve dhe didaktizmit që përmban, konsiderohet si letërsi e emergjencës, që e ndihmon shumë funksionimin e shkollës shqipe, duke i ofruar asaj, letërsi didaktiko-pedagogjike, duke ofruar sa më shumë njohuri e informacione nga fusha të ndryshme të dijes, për të plotësuar mungesën e teksteve të lëndëve mësimore, të fushave e lëndëve të veçanta. ( Qibrie Demiri, “Letërsia për fëmijë”, “Rozafa”, Prishtinë, 2011, f. 22 ). Ky lloj i letërsisë, vazhdon zhvillimin e saj deri në Luftën e Dytë Botërore, për t’u pasuar nga letërsia realiste dhe ajo postmoderniste.

Letërsia për fëmijë, është letërsi që i ofrohet fëmijës-nxënësit (pa u përjashtuar edhe lexuesi i rritur, i cili përkujdeset për të, si prindi, mësuesi apo studiuesi) dhe duke qenë se i ofrohet këtij, ajo zhvillohet duke i realizuar dy aspekte, atë letrar dhe atë pedagogjik-edukativ. Pra, letërsia për fëmijë i ka specifikat e veta, të kushtëzuara nga subjekti, të cilit i dedikohet. Duke iu dedikuar lexuesit të ri, të vogël, me personalitet të paformuar dhe me delikatesën e gjithanshme që ka vogëlsia e tij, krijuesi i letërsisë për fëmijë, si i rritur që është, duhet të njohë thellë lexuesin e tij, në mënyrë që t’ia përshtatë nevojave, dëshirave, preokupimeve dhe botës së tij. Shkrimi për fëmijë, do shumë kujdes, sepse si “bashkëbisedues” nuk e ka njeriun e rritur, por atë më të vogël, në çdo aspekt: fizik, intelektual, psikologjik e shpirtëror. Kështu që në letërsinë shqipe për fëmijë, rrallë e kemi

një krijim të pastër artistik, siç e kemi në letërsinë për të rritur (p.sh. Lasgushi, Pashku etj.). Të shumtën e rasteve, kjo letërsi, përveç pasionit artistik, e ka edhe misionin e saj të natyrave të ndryshme: patriotik, etik, moral, psikologjik, didaktik e më pak atë emocional. Prandaj, shumë rrallë, letërsia shqipe për fëmijë, ka mundur të shpëtojë nga molepsjet dhe ngarkesat e natyrës jashtë-artistike, moralizuese e edukative, e shpesh edhe ideologjike, për të dhënë vetëm kënaqësinë e nevojshme artistike dhe përjetime estetike.

Fenomeni i intencës në letërsinë për fëmijë, në situata e rrethana të caktuara sociale, ndoshta është edhe domosdoshmëri, në mënyrë që ajo të ndikojë në formimin e gjithanshëm të tij. Mirëpo, letërsia për fëmijë si art, funksion fundamental të saj, e ka edukimin e fëmijës-nxënësit, në aspektin artistiko-estetik, sepse ai duhet të plotësohet edhe me njohuri artistike, si vetia më subtile e më fisnike e njeriut dhe “Letërsia nuk i ndryshon gjërat, por nëse lexuesi lexon me vëmendje, ajo futet në mendjen dhe në shpirtin e njeriut dhe pastaj ai patjetër që për një nuancë është më ndryshe”. (Salman Ruzhdi – intervistë në “Top-chnal”, 01.10.2012 ).

### **3.3. Karakteri social i Letërsisë për fëmijë dhe estetika e saj**

“Arti është burim i lirisë dhe nuk duron të marrë urdhra nga nevoja të tjera, përveç nga domosdoshmëria e shpirtit”,( Fridrih Shiler, “Mbi edukimin estetik të njeriut”, Tiranë, 2004, f. 16), megjithëkëtë, kultura, artet e një populli dhe letërsia në mënyrë të posaçme, patjetër që janë të ngarkuara edhe me rrethanat, fatin, jetën, situatat historike, politike e sociale të tij. Kështu që edhe



letërsia për fëmijë, sidomos ajo e realizmit, përveç anës subjektive të krijuesit, është reflektim i kohës kur është shkruar, me gjithë specifikat e saj dhe shpesh edhe forma edhe përmbajtja e kësaj letërsie, është kushtëzuar nga konteksti social, për të mos thënë edhe ideologjik (gjatë periudhës komuniste). Kjo, në një mënyrë edhe e ka dëmtuar aspektin estetik e kreativ të artit dhe krijimtarinë artistike përgjithësisht, por e ka sforcuar aspektin social, trajtimin, pasqyrimin e aktualitetit, problematikën që masën e shqetësonin shpirtërisht, ekzistencialisht e politikisht. Në fakt, edhe kjo është një vlerë e artit, por e natyrës jashtë estetike. Kurse, letërsia për fëmijë e kohës së romantizmit, impaktin e vet social, është munduar ta realizojë përmes mundësisë së kreacionit, duke ikur nga realiteti jetësor e duke u strehuar krejtësisht në imagjinativen, në idealen, në të bukurën e jetës (Naimi, De Rada, Ndre Mjeda, Çajupi etj). Teoritë romantike forcën e së bukurës, estetikës, e shihnin në fantazinë, në lirinë krijuese, në ëndërrimet fantastike dhe në idetë e tyre, se dukuritë estetike, e veçanërisht artet, ishin një instrument i rëndësishëm për të luftuar padrejtësitë sociale, për të ndërtuar parajsën sociale mbi tokë. Po ashtu, iluministët, artin e quanin njohje, dije dhe mjet për përsosjen morale e sociale të njeriut. (Alfred Uçi, “Estetika”, vëllimi I-II-III, Tiranë, 1986, f. 18). Kurse shumë krijues, që pasonin pas periudhës së rilindësve, idetë e tyre filozofike, ideologjike, politike e sociale, i shndërronin në art estetik letrar. Si formë artistike e ideve socio-politike, ishin pothuaj të gjitha poezitë e Nolit, prozat e Migjenit, romanet e Spasses, Xoxës, H. Sylejmanit etj. Nuk kemi dokument më real, as histori më të vërtetuar e më të bindshme për kohën sesa prozat brilante të Migjenit: ‘Luli i vocërr’, ‘Bukuria që vret’, ‘Legjenda e misrit’,

etj. Po ashtu, një fotografi shumë e sinqertë, për gjendjen politiko-sociale të kohës, është poezia „Anës së lumenjve,„ e Nolit, apo realiteti i Shqipërisë së pasluftës në romanin ‘Lumi i vdekur’, e shumë e shumë të tjera, që janë si ikona të realitetit social të kohës së tyre.

Aspekt tjetër i artit letrar është, reciprociteti në raport me gjendjen sociale, do me thënë, sikur që ky art, ka ndikim në zhvillimin social, ashtu edhe zhvillimet sociale, ndikojnë në anën përmbajtjesore e estetike të tij. Ndërgjegjësimi për artin, perceptimi i tij, vlerësimi, krijimi dhe nevoja për të, varen nga praktika shoqërore, sa ajo është në gjendje të ofrojë vlera estetike dhe të kërkojë ato, nga individët dhe shoqëria përgjithësisht. Duhet të zhvillohet përpjekja për të krijuar art për shoqërinë, por edhe shoqëri për artin (shoqëri që e do dhe ndien nevojë për të). “Gjithë përmirësimi i sferës sociale e shtetërore, duhet të rrjedhë jo nga politika, por nga fisnikërimi i karakterit të njeriut që nga fëmijëria e tutje. Dhe instrumenti më i qëlluar i edukimit të shoqërisë, është arti dhe e bukura përgjithësisht” (Fridrih Shiler, “Mbi edukimin estetik të njeriut”, Tiranë, 2004, f. 32). Mendohet që ngacmimi emocional i së bukurës, orienton fëmijën dhe njeriun përgjithësisht, kah gjërat më pozitive, kah krijimi i shijes për çdo aspekt të jetës, kah krijimi nevojës dhe ndjenjës për të bukurën dhe largimin nga e kundërta e kësaj. “Edhe përmirësimi i sferës politike, si përcaktues i zhvillimeve sociale, duhet të rrjedhë nga fisnikërimi i karakterit e shpirtit të politikës, i cili mund të bëhet vetëm përmes artit. Shpirti i tyre nuk mund të fisnikërohet përmes kushtetutave e ligjeve” (Fridrih Shiler, “Mbi edukimin estetik të njeriut”, Tiranë, 2004, f. 47 ).

Pra, arti në përgjithësi dhe letërsia në veçanti, fundamentalisht, kanë karakter social. Arti i secilës kohë, patjetër që përfaqëson specifikat e shoqërore, të cilave s'mund t'u ikë, nga fakti, se ai është pjesë e saj. Arti është krejtësisht shpirtëror, buron nga shpirti. Për këtë nuk mund të jetë indiferent ndaj problematikave, rrethanave jetësore individuale e sociale, sepse ato e rëndojnë krijuesin emocionalisht e shpirtërisht, e shqetësojnë atë dhe patjetër që shumë vlera artistike përgjithësisht e letrare veçanërisht, janë si rezultat, apo reflektim i atyre shqetësimeve. “Arti është reflektim i kohës”, thotë Aristoteli, e për ta reflektuar kohën, mundësitë më të mëdha si art i ka letërsia (asnjë lloj kronologjie as historie nuk do të na ofronte dhe nguliste në kokë më mirë njohuri për mënyrën e jetës së popujve të tyre, sesa që e kanë bërë përmes letërsisë, Homeri, Tolstoji, Dostojevski, Balzaku, Kadareja, etj). Kështu që edhe letërsia jonë në përgjithësi dhe ajo për fëmijë në veçanti reflektojnë kushtet, rrethanat e veçantitë historike, politike e shoqërore.

### **3.4. Letërsia për fëmijë, në funksion të ndërgjegjësimit patriotik – estetika patriotike**

Arti popullor, ka qenë fundament e burim i krijimit artistik dhe mjet i fuqishëm edukativ në përgjithësi e i edukimit estetik në veçanti. Ndjenja e hollë për të bukurën dhe shija e tij e lartë artistike, kanë performuar kudo, në çdo aspekt krijues dhe jetësor të tij. E tërë kultura e krijimtaria e popullit, përfaqëson dhe reflekton identitetin e gjithanshëm të tij, punën, zakonet, mënyrën e jetës, rrethanat jetësore, në të cilat historikisht e aktualisht jeton.

Kështu që çdo art, e më së shumti letërsia, e cila e ka mundësinë më të madhe të shprehjes, zhvillohet krahas zhvillimit të popullit, së bashku me peripecitë, luftërat dhe historinë e tij. Prandaj, ashtu, si çdo art tjetër për fëmijë, edhe letërsia, përveç qëllimit të tij estetik, argëtues e fisnikërues, të shumtën e rasteve ka qëllim edhe edukativ e ndërgjegjësues. Pra, edhe letërsia jonë për fëmijë, gjithnjë ishte në funksion të edukimit kombëtar, të krijimit e zhvillimit të ndjenjës për vendin, popullin dhe identitetin e tij. Fillimisht letërsia gojore; këngët, përrallat, legendat, baladat, kashelashat, fabulat, mitet, ninullat dhe lojërat e ndryshme, të gjithat kishin përmbajtjen ku hyjnizoheshin bukuritë e vendit, e virtytet e popullit. Pastaj edhe letërsia e shkruar, vazhdon me intencë të këtij komponenti, për ndërgjegjësimin patriotik të fëmijëve-nxënësve e kështu edhe të popullit përgjithësisht sepse, duke e ndërgjegjësuar fëmijën, ndërgjegjëson shoqërinë e ardhme të një populli. Pra, si makrotemë e letërsisë sonë për fëmijë, për shumë kohë (edhe tek ajo gojore edhe tek ajo e shkruar), ishte plani patriotik, ku krijoheshin apologji për gjuhën shqipe, forcën e bukurinë shprehëse të saj, për kombin e vetitë morale të tij, për vendin e bukuritë natyrore e gjeografike të tij, etj. Nuk ka pothuajse asnjë shkrimtar, që i takon tipave krijues të letërsisë për fëmijë, prej asaj didaktiko-moralizuese, romantike, sociale, realiste e folklorike, e deri te tipat krijues të e imagjinatës së lirë, që nuk ka shkruar së paku një poezi, për ikonat e identitetit kombëtar të tij, për gjuhën, për popullin, për vendin e tij. Asnjë nga krijuesit e krijimtarisë letrare për fëmijë, nuk i ka shpëtuar pa përmendur në domenin e tij krijues, leksikor e simbolik, figurën e Skënderbeut, virtytet e kombit, trimërinë e historinë rezistuese të tij. Më të

përkushtuarit në këtë aspekt, ishin shkrimtarët e Rilindjes Kombëtare, sepse në një mënyrë edhe e kishin të kushtëzuar, të imponuar nga rrethanat politike, arsimore e sociale përgjithësisht. Secili krijues i kësaj periudhe, intencë permanente e primare e kishin, aspektin e ndërgjegjësimit të popullit, e të fëmijëve në mënyrë të veçantë (si e ardhmja e shoqërisë), për krijimin e kultivimin e ndjenjës ndaj vendit të tyre. Këtë, përpiqeshin ta realizonin, përmes mundësisë që u jepte lloji i artit që e kultivonin, sidomos ai romantik, duke paraqitur vendin, kombin e tyre, ashtu siç ata e dëshironin apo ëndërronin. E kësaj natyre është P.sh., “Bagëti e Bujqësi” e Naimit, ku Shqipëria paraqitet si një parajsë natyrore. Kur i referohemi kësaj poeme të Naimit, ne patjetër që ndjejmë kënaqësi, e përjetojmë dhe e përfytyrojmë natyrën e bukur shqiptare, përmes mjeshtërisë së poetizimit të autorit, aty përjetojmë ndjenjën e dashurisë, mallit e dëshpërimit që përshkojnë poemën. Gjatë leximit të vëmendshëm, sikur e jetojmë edhe ne bashkë me poetin tërë atë që është aty dhe ky nuk është tjetër vetëm përjetimi estetik i një vlere artistike. Po të përshkruante Naimi të njëjtat gjëra e fenomene të natyrës shqiptare, por me fjalë të rëndomta, të thjeshta, ne nuk do të ndjenim atë hipnotizim poetik, atë kënaqësi që na ofron poema e tij. Kjo është vlere estetike, e cila patjetër që ndikon në formimin e shijes estetike të lexuesit-nxënësit në këtë rast. Apo Gjergj Fishta, i cili gjuhën shqipe e krahason kështu:

“Porsi kanga e zogut të verës

Që vallzon n,blerim të prillit

Porsi i ambli fllad i erës

Që lëmon gjijtë e trëndafililit

Posi vala e bregut t, detit

Porsi gjama e rrfesë shgjetare

Njashtu asht gjuha jonë shqiptare”. (Rita Petro, Xhevat Syla, “Leximi letrar 6”, Botime Shkollore, Prishtinë, 2004, f. 23 )

Krijuesit rilindas, kishin ambicie arsimore, në fakt punuan e krijuan vetëm për avancimin e idesë patriotike te fëmijët dhe te populli, në mënyrë që ai të forcohej e të motivohej për të luftuar e mbrojtur vendin nga shpërbërja, shkatërrimi e asimilimi i tij, për shkak se jetonte në rrethana okupuese. Ky fakt, i bënte ata më këmbëngulës, në kultivimin e lirikës patriotike (e cila u bë edhe si themeltare e letërsisë për fëmijë), që ishte si një mënyrë e luftës kundër okupimit dhe si armatim emocional, për ta shporrur atë. Për këta krijues, vetëm pas aspektit patriotik, vinte aspekti estetik i krijimeve të tyre, për ta formuar e avancuar edhe ndjenjën e shijen ndaj të bukurës, krahas ndjenjës së atdhedashurisë. Sepse në disa rrethana humane, kur në rrezik është ekzistenca e vendit, kombit e individit të tij, estetikja nuk ka asnjë lloj kuptimi. Shumë krijues, që pasonin pas periudhës së rilindësve, idetë e tyre filozofike, ideologjike, politike e sociale, i shndërronin në art estetik letrar. Si formë artistike e ideve socio-politike, ishin pothuajse të gjitha poezitë e Nolit, prozat e Migjenit, romanet e Spases, Xoxës, H. Sylejmanit etj. Meqenëse jeta dhe zhvillimi i popullit tonë prej që ekziston, ishte në kontinuitet me probleme e delikatesa ekzistenciale edhe artet e tij si reflektim i kohës, i emocioneve, ndjenjave dhe shpirtit të kësaj shoqërie, kanë gjithnjë deri në ditët e sotme, elemente të dashurisë nacionale, si kundërvënie të vështirësive, me të cilat përballet. Sot, akoma i

shkruhet lirisë, trimërisë, atdhedashurisë dhe kësaj ndenjeje, nuk i kthehemi në retrospektivë, por në perspektivë, sepse kemi nevojë shumë ta duam popullin dhe vendin tonë, që deri tani e kemi mbrojtur nga armiqtë, kurse tani nga ‘keqorientimet sociale’, nga ‘keqeducimi’, e nga denacionalizimi.

### **3.5. Karakteri moral, etik dhe didaktik i Letërsisë për fëmijë**

Letërsia për fëmijë, është një formë e artit, përmes së cilës mund të ndikohet në edukim të posaçëm estetik, por edhe në edukim të përgjithshëm të lexuesit fëmijë. Synim i saj është, fëmija më sensitiv, më human, më i ditur, më i dashur, më i kalitur, më i gjithanshëm, më i dobishëm për veten e për shoqërinë. Përmes saj, ndikohet në ngritjen shpirtërore, në emancipimin e ndjenjave të tyre, në kultivimin e shijes për të bukurën. Letërsia ndikon edhe në ngritjen e aspektit logjik e intelektual të fëmijëve, që ata të dinë të dallojnë të drejtën, të vërtetën e njerëzoren, etj. përmes situatave kreative, letrare.

Përderisa ndër parimet apo kriteret e letërsisë për fëmijë, është edhe ai i ndikimit në zhvillimin e gjithanshëm të personalitetit të fëmijës dhe përgatitja e tij për situata të ndryshme jetësore, karakterin edukativ, etik e moralizues kësaj letërsie, ia përcakton në një mënyrë edhe rrethana shoqërore, në të cilën ajo krijohet. Sepse në fakt, letërsia i dedikohet lexuesit (në këtë rast fëmijës) dhe realizohet si qëllim, vetëm nëse komunikohet me të. Për të komunikuar me lexuesin, duhet plotësuar atij nevojën estetike, por varësisht nga nevojat dhe qëllimet, duhet të plotësohet edhe

nevoja etike, morale e didaktike. Letërsia si edukim i karakterit, përmes trajtimit të përmbajtjeve të ndryshme letrare dhe përmes situatave konfliktuoze e personazheve me karaktere nga më të ndryshmet, synon që tek fëmijët, të kultivojë virtytet humane: besën, guximin, bujarinë, nikoqirllëkun, respektin ndaj të tjerëve dhe ndaj ambientit ku jeton, e në mënyrë të veçantë ndaj të bukurës, kudo që e hasin, në natyrë apo krijimtari artistike.

“Arti në përgjithësi dhe letërsia në veçanti, ndikojnë dhe ndihmojnë në pasurimin e gjuhës, në krijimin e identitetit të individit dhe të popujve” ( Umberto Eco, “Si shkruaj” , AIKD, Prishtinë, 2003, f. 110).

Edukimi estetik, i cili është tipar i arteve, është i lidhur ngushtë edhe me moralen dhe etiken. Përmbajtjet letrare, zhvillojnë dhe ngjallin emocione të ndryshme, përmes situatave artistike, letrare të dhembshme, të hareshme, të guximshme, etj., në përmes realizimit të personazheve të ndryshëm, saqë arrijnë të ndikojnë më thellë e më fuqishëm, në ndërgjegjësimin etik e moral të fëmijëve, sesa shpjegimet e shumta nga lëndë më profesionale të kësaj natyre; etikë, psikologji, filozofi, sociologji, etj. Pastaj, përmes një materiali të realizuar estetiko-letrar, mund të ofrohen shumë më bindshëm njohuri historike, filozofike, sociale, politike, shpesh edhe gjeografike dhe në mënyrë më të efektshme, sesa përmes ndonjë lënde tjetër adekuate. Sepse letërsia, e ka mundësinë më të madhe, të shprehjes më të natyrshme dhe më spontane, për aspektin e nxënies së njohurive apo ngulitjes së tyre, tek lexuesi. (P.sh. Skënderbeun, shumë më mirë e njohim



përmes vlerave estetiko-letrare që i janë kushtuar, sesa përmes historisë).

Ndërkaq, arti letrar popullor, ishte i pari, që ofronte përmbajtje edukative, moralizuese, etike, historike etj. Pra, artet e çdo populli janë të ngarkuara me realitetin, fatin dhe zhvillimet e atij populli që e krijojnë. Edhe krijimet tona popullore (zejet, punëdoret, arkitektura, dekorimet në veshmbathje e ambient e kudo) dhe krijimet gojore, si: këngët, epet, mitet, përrallat, legjendat, anekdotat, fabulat, kashelashat, e deri tek ninullat, shprehin botëkuptimin dhe qasjen ndaj jetës e fatit me të cilin ballafaqohet populli jonë. Por krahas kësaj, ato përmbajnë edhe mesazhin e tyre, secila në mënyrën e vet të shprehjes specifike. Këto posedojnë me vete filozofinë, psikologjinë, etikën e moralin popullor, si dhe porosinë didaktike e moralizuese, e cila përherë e ka si qëllim, njoftimin dhe komunikimin me lexuesin (në këtë rast lexuesin fëmijë), lidhur me situatat e jetës dhe kalitjen e tij ndaj sfidave të ndryshme e të mundshme, të jetës. Krijimet popullore për fëmijë, i mësojnë ata, të dallojnë të mirën nga e keqja, të dobishmen nga e dëmshmeja, njerëzoren nga e panjerëzishmeja, etj. Këto, ndihmonin funksionimin më të rregullt e më të organizuar të individit, familjes e shoqërisë përgjithësisht. Përmes këtyre poetizimeve (qofshin ato këngë, legjenda, epe, përralla, fabula, anekdota apo ndonjë lloj tjetër i krijimit gojor), kultivoheshin vlera e virtyte njerëzore, të cilat njerëzit i bënin më të motivuar, më të fortë e më humanë, por edhe më luftarakë kur nevojitej. Ishin këto krijime strukturalisht të thjeshta e të shkurtra, por me simbolikë, filozofi të madhe dhe me aludime të dukshme të natyrës etike-morale. Personazhet e tyre, ishin zakonisht

shtazët e personifikuara, ose figurat mitologjike (më rrallë njerëzit) dhe secili nga këta, përmes alegorisë dhe gjuhës universale, përfaqëson nga një karakter specifik, që reflekton një mësim, një përvojë dhe njohuri për jetën. “Letërsia gojore është letërsia e parë për fëmijë dhe shtyllë mbajtëse e kësaj letërsie. Kjo po ashtu ishte edhe si një burim ose ushqim për letërsinë e shkruar për fëmijë në mënyrë të vazhdueshme. Një letërsi e tillë e tipike ishte letërsia jonë për fëmijë e kohës së Rilindjes Kombëtare, letërsia e shkollave të para shqipe, e cila ishte letërsi mësimore, didaktike, moralizuese dhe e përfaqësuar kryesisht nga fabula si formë e vjetër e letërsisë” ( Qibrë Demiri, “Letërsia për fëmijë”, “Rozafa”, Prishtinë, 2011, f. 304).

Në fakt, në kohën e krijimit të tyre, vlerat e letërsisë popullore, ishin edhe i vetmi institucion edukimi e emancipimi për fëmijët dhe popullin, derisa filloi letërsia e shkruar dhe hapja e shkollave. Kurse periudha e letërsisë së shkruar didaktike e moralizuese, fillon me letërsinë e rilindësve tanë. “Që nga antikiteti i Greqisë, si art nuk kuptohej vetëm letërsia (drama, poezia, muzika) por edhe kompleksiteti i mjeshtërive të ndryshme - zejet, madje edhe teknika e ndërtimit të anijeve, etj. Në atë kohë nuk përdorej fjala estetikë, por bukuri, e cila nënkuptonte dhe identifikohesh me mirësinë, dobinë, dijet dhe vërtetësinë” ( Alfred Uçi, “Universi Estetik”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2007, f. 64). Pra historikisht, lidhja e artit me moralin, është e ngushtë dhe akoma më e ngushtë është, te krijimtaria për fëmijë.

Edhe estetika, si teori mbi të bukurën, e shqyrton si çështje të saj, raportin e së bukurës me moralin, sepse morali ka të bëjë, përveç

me të bukurën në natyrë e në krijimtari artistike, edhe me bukurinë shpirtërore. Realizim estetik, në artin letrar, është edhe madhështia shpirtërore, e që gjithsesi është, përveç vlerë estetike, edhe vlerë morale (P.sh. Gjergj Elez Alia).

Qysh herët, është ditur për ndikimin që ka arti, në moralin e njeriut, kurse Platoni thoshte se, art mund të jetë vetëm ai krijim, i cili ka funksion moralizues. I patejkalueshëm në mendimin për funksionin e artit (si edhe në shumë aspekte të tjera të njohjes), ishte Aristoteli, i cili thoshte se: “Arti i ka këto funksione: argëtimin, edukimin, njohjen dhe pastrimin e shpirtit përmes fenomenit të katarsisit, sado që si funksion primar, e konsideron atë të argëtimit dhe kënaqësisë, që shkakton vlera estetike dhe njohja e jetës përmes saj. Arti e ushqen njeriun me kënaqësi intelektuale dhe morale” (Alfred Uçi, “Universi Estetik”, **Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2007, f. 85**). E, sipas doktrinës iluministe, arti është shkollë, për kultivimin e së mirës, së bukurës dhe virtytit. Po sipas këtyre, ndikimi i artit, qëndron në ngarkesën emocionale që përmban, sepse prekja në emocion, në ndjenja, është më e ngulitur dhe më e qëndrueshme. Edhe sipas Rilindësve (Naimit, De Radës etj.) ana morale e artit, është më e vlefshme, sesa ana estetike, por është mirë që në art, të harmonizohet moralja me estetikën, apo të bëhet estetizimi i moralizimit. Ndërkaq Kanti e Shileri, thonë se njeriu pa etikë e pa moral, nuk mund ta shijojë as ta krijojë të bukurën sepse njeriut të tillë, nuk i shkakton kënaqësi e bukura. Arti edhe nëse fare nuk ka përmbajtje moralizuese, vetëm si estetikë, si e bukur, ndikon në etikë-moral të njeriut. Pra, arti, sado që është i pavarur nga moralja, ekziston në të. E moralshmja mund të burojë nga

estetikja, sepse estetikja avancon virtytet, fisnikëron shpirtrat. Moralizuesja e dëmton artin e mirëfilltë estetik, edhe letërsinë për fëmijë në këtë rast, kurse estetikja e lartëson moralin vetvetiu. (Kurse, sipas Sabri Hamitit, te letërsia me mision, humbet pasioni e imagjinaria dhe realizohet artificialiteti në art). Në art, e moralshmja nuk mund të qëndrojë pa artistiken, kurse artistikja edhe pa moralizuesen mund të qëndrojë dhe të jetë e moralshme. „Tek romakët, Dante Aligeri të bukurën e lidh edhe me kategorinë **e së ndershmes**” (Ibrahim Rugova, “Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983”, Prishtinë, 1983, f. 37 ). Kurse, sipas parimit filozofiko-moral të De Radës, kategoria e së ndershmes është kulminacion i së mirës në art, në jetë, në rregullimin shoqëror e njerëzor. Sipas tij, e bukura është gjithmonë edhe morale, është burim i gjërave pozitive dhe i shërben përsosjes së jetës njerëzore (Ibrahim Rugova, “Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983”, Prishtinë, 1983, f. 37 ).

## **IV. LETËRSIA DHE FORMIMI ESTETIK I NXËNËSVE NË SHKOLLË**

### **4.1. Estetika në procesin edukativ-mësimor**

Pjesë thelbësore e edukimit të përgjithshëm dhe synimi i çdo sistemi arsimor, është edhe edukimi estetik, i cili realizohet si komponentë e veçantë e edukimit të përgjithshëm në shkollë dhe i cili në vete përmban si objektivë, krijimin e idesë, shijes për të bukurën tek nxënësit, pastaj aftësimin e nxënësit për ta vërejtur, për ta përjetuar, vlerësuar dhe krijuar të bukurën. Ndjenjat, shijet estetike, në një shkollë, i posedojnë të gjithë fëmijët e njerëzit në përgjithësi, çështja është që nëpërmes metodave emancipuese e arsimore, ato të zhvillohen e të përsosen, sa më shumë. D. th. nxënësit në shkollë, të aftësohen sa më shumë për dallimin e asaj që është e bukur, e shëmtuar, e drejtë, e ulët, madhështore, e dobishme, etj. dhe të mprehin „gjykimin,, estetik. Sepse, një vepër letrare, mund të jetë një shkollë më vete, e cila luan rol, në formimin dhe përforcimin e karakterit të fëmijës (një akt jetësor i krijuar nga invencionin artistik i shkrimtarit, përmban edhe përvoja reale nga jeta, e cila mund të jetë një mësim për lexuesin e vogël-fëmijën).

Vetëm duke e organizuar zhvillimin e këtyre komponentëve, në mënyrë të planifikuar, tek nxënësit, mund të krijohet, të kultivohet, të vërejturit, pranimi dhe përjetimi i vlerës estetike, dhënia e mendimit për të dhe krijimi i mundshëm estetik, nga nxënësit (në kuadër të lëndëve përkatëse, krijimi i pikturës, skulpturës, këngës, i hartimit ose esesë etj). Detyrat e edukimit estetik në shkollë, realizohen përmes mjeteve e përmbajtjeve të

ndryshme, të fushave e lëndëve të artit (edukatë fizike, ed..muzikore, art figurativ e veçanërisht përmes lëndës gjuhë e letërsi shqipe), përmes së cilave duhet ofruar nxënësve vlera të theksuara estetike, në mënyrë që atyre, t'u bëjnë përshtypje dhe të ndiejnë nevojë për to. Përmbajtjet estetike të cilësdo lëndë, që u ofrohen nxënësve, duhet të jenë konform parimeve të edukatës estetike, e cila e fisnikëron shpirtin dhe mendjen e fëmijës. Interesimi i tij për artin dhe për estetikën, nuk është trashëgim, ai kultivohet, zhvillohet gradualisht dhe sistematikisht. "Kureshtja dhe dëshira e fëmijës për të bukurën, i nxitet duke filluar nga familja, mjedisi ku jeton dhe shoqëria, por në mënyrë të veçantë kjo realizohet përmes shkollës, gjatë procesit edukativo-arsimor, e sidomos përmes lëndës së letërsisë"( Grup autorësh, "Pedagogjia", Zagreb, 1978, f. 205 ) . Secili lloj i artit, i ka mjetet e veta shprehëse, përmes së cilave ai shpreh intencën-vlerën e vet estetike. Për t'u realizuar qëllimi i edukimit estetik, fëmijëve, e në këtë kontekst nxënësve, përveç që duhet t,u ofrohet vlerë estetike, ata duhet edhe që të aktivizohen në vazhdimësi në këtë aspekt, në mënyrë që ai të jetë në kontakt dhe në komunikim me cilësi estetike vazhdimisht, që ai ta pranojë, ta përjetojë e t'i bëhet e nevojshme kjo. Pa iu orientuar ana emocionale e psiko-shpirtërore kah vlerat estetike, njeriut qysh si fëmijë, vështirë do ta vërejë, t'i dojë e t'i përjetojë ato më vonë. Fëmija-nxënësi, që përjeton impakt estetik, bëhet më i butë në karakter, më i ndjeshëm, më etik, më human dhe shpirtërisht e fizikisht, qëndron më i distancuar nga vrazhdësia, brutaliteti, e devijimet e ndryshme sociale. Fëmijët e edukuar estetikisht, bëhen edhe më komunikues, më të afërt, më të përgjegjshëm e më solidarë në situata. Kështu që edukimi estetik është faktor shumë i

domosdoshëm, për formimin sa më pozitiv e më të gjithanshëm të personalitetit të fëmijës. Dhe, të mësuarit përmes artit, është një mënyrë e domosdoshme, që krijon efekte praktike, në forcimin e mendjes e shpirtit të nxënësit.

#### **4.2. Letërsia në shkollë, domosdoshmëri estetike dhe didaktike**

Edukimi estetik, si dimension zhvillimor i individit, ka rëndësi të shumëfishta në realizimin e qëllimit të edukatës përgjithësisht. Prandaj, ky lloji i edukimit, është edhe një aspekt i pedagogjisë, i cili e vë nxënësin në pozitë të komunikimit me krijimtarinë artistike. Kurse njëra ndër mënyrat e komunikimit me artin, është edhe të lexuarit, që është një aktivitet i domosdoshëm dhe burim kryesor informatash të çdo fushe, por edhe mënyra e vetme e komunikimit, me artin letrar. Për këtë, prindërit që në vegjëli, duhet të familjarizojnë fëmijët me librin, varësisht nga mosha, fillimisht në formë lodre, pastaj duke ia prezantuar atij si burim ilustrimesh, përrallash e ngjarjesh joshëse, për kureshtjen imagjinatën e preokupimet e tij, në mënyrë që të jetë i parapërgatitur për komunikim me librin dhe me letërsinë në veçanti.

Mundësitë më të mëdha për edukimin emocional, shpirtëror e estetik të fëmijës-nxënësit, i posedon letërsia, si lloj specifik i artit mbi jetën. “Leximi i librave të ndryshëm letrarë „edukon,, imagjinatën, zbulon përfytyrimin e fëmijës për të mundshmen në jetë”( Northrop Fraj, “Anatomia e kritikës”, “Rilindja”, Prishtinë, 1990, f. 24 ). Përmes letërsisë, fëmija përveç që kontakton me

situata të ndryshme të mundshme, për jetën individuale, e njerëzore përgjithësisht, ai zbulon edhe kultura të ndryshme, (përveç asaj të popullit të vet) dhe civilizime të vendeve e të kohëve të ndryshme, të vështruara në kontekst më të thelle e më të gjerë kulturor, social e psikologjik. Prandaj, ndër çështjet themelore të shkencës mbi edukimin (pedagogjisë), është edhe edukimi estetik, i cili duhet të realizohet si veprimtari edukative e planifikuar, e sistemuar, e qëllimshme, për përfitim të një sistemi të njohurive, shprehive e shkathtësive dhe zhvillimit të interesimit permanent për kategoritë dhe vlerat estetike, për të gjithë lëmenjtë e artit (për t'i hetuar, gjykuar, vlerësuar e krijuar ata), në mënyrë që të avancohet personaliteti i fëmijës, në mënyra të gjithanshme.

Për shumë shekuj, arti dhe vlerat estetike, janë konsideruar si aktivitete jo mendore, joracionale, por në fakt, në procesin e realizimit të edukimit e ndërgjegjësimit estetik, aktivizohen e zhvillohen funksione dhe aftësi të shumta intelektuale, siç janë: perceptimi, vrojtimi, kujtesa, aftësia për reproduktim, të menduarit kritik e krijues, si dhe zhvillimi i imagjinatës, për çdo veprimtari. Pastaj, përmes edukimit estetik, përmes njohurive për artin e për letërsinë në veçanti, begatohet diapazoni mendor i fëmijës-nxënësit, jeta e tij emocionale dhe formohen pikëpamje e qëndrime më të pjekura për botën.

Në literaturat bashkëkohore, vërehen tendenca edhe të zëvendësimit të nocionit **edukim estetik**, me nocionin **edukim përmes artit**, sepse vetëm përmes artit, njeriut mund t'i ofrohet e bukura, në mënyrë më të plotë. Arti në shkencën e pedagogjisë, zë një vend me rëndësi, si një mënyrë shumë efektive për



edukimin e brezave, në mënyrë më të gjithanshme. Të bukurën si kategori fundamentale estetike, De Rada në veprën e tij „Parimet e estetikës,, ( Jeronim de Rada, “Parimet e estetikës”, 1861 -marrë nga Rexhep Qosja, “Historia e letërsisë shqipe III-romantizmi”, ‘Rilindja’, Prishtinë, 1986), artet i sheh në tri fusha: në natyrë, në njeriun-personalitetin e fizikun e tij dhe në arte. Kurse, Aristoteli si gjeni i gjithanshëm dhe në shumë çështje i patejkalueshëm, edukimin estetiko-artistik e konsideron si faktor qenësor, të zhvillimit dhe formimit të personalitetit të njeriut dhe derisa Platoni thoshte se arti e shpreh individualen, Aristoteli thoshte që arti e shpreh universalen, të përgjithshmen në natyrë e shoqëri. Po ashtu, Aristoteli (tek “Poetika,,) thotë që arti është i dobishëm, është si terapi mjekësore dhe e pastron njeriun nga emocionet negative. Së këndejmi e thekson edhe „katarsis-in,, si spastrim emocional-shpirtëror, sepse arti, e bukura, avancon shpirtëroren përmes argëtimit, dëfrimit që e shkakton, kështu që edhe fisnikëron personalitetin e njeriut. Arti është burim i shpirtërores dhe synim i tij është fisnikërimi i saj. Kështu që, edukimi estetik, është i pazëvendësueshëm në aspektin e stabilitetit e qetësisë psikologjike të njeriut, me lëmenj të tjerë edukativë.

Prandaj, ndër komponentët fundamental të edukimit, që nuk mund të nënkuptohet vetëm si „shkathtësi,, apo vetëm si formë e dëfrimit, argëtimit, por si një nevojë për zhvillimin e qytetërimit, është edukimi estetik i individit dhe shoqërisë përgjithësisht, të cilit duhet kushtuar shumë rëndësi, përpiluesit tonë të plan-programeve shkollore. Planet e lëndëve mësimore, që kanë si objektivë edukimin estetik, duhet të përmbajnë vlera të mirëfillta dhe të jenë të përshtatura me moshën e fëmijës dhe kohën,në të cilën jetojmë. Ndërkaq, çështje më vete, është edhe problemi i

metodikës, e teknikave për ta ndërlidhë objektin me subjektin - vlerën estetike me fëmijën apo nxënësin . Mësuesi duhet të orientojë drejt fëmijën, në raport me vlerën estetike letrare, ngase letërsia për fëmijë, përmban një mori aspektesh të edukimit si të atij estetik e kulturor edhe moral e didaktik në përgjithësi.

### **4.3. Faktorët që ndikojnë në performancën e letërsisë në shkollë**

Strategjitë zhvillimore të arsimit, gjithnjë synojnë edukimin e shoqërisë, në çdo fushë e aspekt, kështu që njëra ndër këto aspekte të edukimit, është edhe edukimi estetik, i cili realizohet përmes lëndëve nga fushat e ndryshme artistike. Mirëpo, arti më i afërt, më i pranueshëm, dhe më i këndshëm, për shumicën e nxënësve, është arti letrar, sepse është arti që ofron më së shumti njohuri të gjithanshme për jetën, përmes mundësive të performancës së saj përmes imagjinatës krijuese dhe përmes kapaciteteve të fjalës. Arti letrar, improvizon situata, karaktere, konflikte e provokime të ndryshme, të cilat reflektojnë momente të ndryshme jetësore. Prandaj, letërsia në shkollë, nuk është vetëm në funksion të edukimit estetik, të përjetimit dhe kënaqësisë estetike, por është në funksion edhe të edukimit gjuhësor (shkrimin e leximit), të edukimit etik, psikologjik, etnik etj. Element kryesor, për ndikimin e duhur të letërsisë tek nxënësi, nuk është vetëm vlera letrare apo përzgjedhja e saj e duhur (në përshtatshmëri me moshën e zhvillimin psikoeemocional e fizik tij), por problematikë më vete është edhe mësuesi i avancuar profesionalisht dhe metodologjia që zbaton ai,

për realizimin e orës së letërsisë, ose të përmbajtjes letrare. Kështu që, si faktor kyç, të edukimit estetik përmes letërsisë dhe ndikimit të saj të sa më të shumanshëm tek nxënësi, janë: **mësimdhënia e letërsisë, teksti shkollor dhe lektyra shkollore.** Në kuadër të këtyre, si forma të veçanta të aktiviteteve të nxënësve, të cilat kanë efekt në kultivimin e shijes dhe dëshirës së nxënësve për të bukurën, janë: leximi, leximi artistik, recitimi, shkrimi i eseve, dramatizimi, si dhe aktivitete të ndryshme kulturore, brenda dhe jashtë shkollës. Edukimi estetik, në raport me të lexuarit artistik (shprehës), lidhet me faktin se edhe të lexuarit bukur, është art, është mundësi e komunikimit artistik që mundëson fjala (gjuha). Të lexuarit artistik, është në funksion të faktit që lidhet drejtpërdrejt me botën shpirtërore, emocionale të interpretuesit dhe përmbajtjes letrare. Sepse, letërsia si art i fjalës së shkruar, njëkohësisht është edhe art i fjalës së lexuar e të interpretuar. Për aspektin estetik, është shumë e rëndësishme që, nxënësi të përjetojë atë që e lexon, të mendojë e të ndjejë bashkë me autorin, që do të thotë ta shpirtëzojë tekstin. Ky është efekti estetik, përjetimi, emocioni. I kësaj natyre, për të ndjerë e për të përjetuar tekstin letrar, është edhe recitimi, i cili, përveç ndjenjës që reflekton, është edhe si ritransmetim i asaj që shkruhet, në pjesën letrare. Procesi i recitimit, është një didakt i mirë, që ka efekt të shumanshëm te nxënësi, si lexim, përjetim, rishfaqje, memorizim, vetëbesim etj. Me rëndësi të veçantë për ndjenjën dhe shijen estetike të nxënësve, është teksti interpretativ-dramatik dhe dramatizimi i tij, sepse fëmijët që në vegjëli, aplikojnë lojëra “teatrore” imagjinatave (ndajnë role e improvizojnë përmbajtje), duke kuptuar kështu botën që i rrethon ata. Kurse në shkollë,

teksti dramatik, dramatizimi i tij, nxënësit i avancon me këto aftësi:

- Për të kuptuar momente jetësore përmes përmbajtjes imagjinatave-dramatike;
- Për të komunikuar përmes ndjenjave ekspresionale, lëvizjes dhe gjuhës, në kontekste reale dhe imagjinare;
- Për të krijuar bashkëveprim me të tjerët;
- Për të zhvilluar një diapazon të gjerë aftësish e teknikash të komunikimit artistik, etj.

Kështu, dramës si art letrar dhe si mënyrë e aktivitetit brenda programit të letërsisë në shkollë, është e nevojshme t'i përkushtohet një numër i orëve mësimore, sepse teksti dramatik, nuk është një tekst i rëndomtë, por është një tekst i ngritur artistikisht, i bukur, i fuqishëm dhe esencial, në raport me përmbajtjen që paraqet. Është një tekst intencional, i parashikuar për skenë, i kombinuar edhe me arte të tjera të skenës, si: muzika, baleti, skenografia, arkitektura etj, dhe njëkohësisht një art shumë atraktiv e shumë i dashur për nxënësit. Pra, dramatizimi si një aktivitet shkollor, është njëra ndër mënyrat më efektive dhe më të fuqishme të përjetimit dhe të përjetësimin të artit letrar, nga ana e nxënësve.

#### **4.3.1. Mësimdhënia e letërsisë**

Natyra e lëndës së letërsisë është e veçantë, ashtu si edhe specifikat dhe objektivat e saj. Sepse letërsia, nuk duhet vetëm të

lexohet e të kuptohet por duhet edhe të nënkuptohet e të lexohet edhe figuracioni i saj artistik. Letërsia për fëmijë, përveç që i dedikohet anës logjike e arsyes-qëllimit të krijimit, ajo i drejtohet edhe emocionit të lexuesit fëmijë. Kështu që, nëse letërsia në shkollë, vetëm lexohet e nuk debatohet, as nuk analizohet në çdo aspekt të saj, është lexuar pothuajse kot. Pas leximit, vlera letrare vetëm duke u analizuar, krahasuar e komentuar, do të ketë ndikimin e saj emocional e njohës tek nxënësi dhe stimulon tek ai natyrshëm, kuptimin e njemendët për estetikën ( kështu që çështje kyçe e mësimdhënies së lëndës së letërsisë në shkollë, është analiza profesionale e tekstit letrar) .

Mësimdhënia e mirë, është parakusht për arritje të suksesshme të nxënies, nga nxënësit dhe parakusht për një mësimdhënës të mirë, është njohja e mirë e lëndës, që trajtohet dhe përcaktimi i metodës më të përshtatshme, për shpjegimin e saj. Kurse parakusht për përzgjedhjen e metodës së mësimdhënies, është njohja e psikologjisë dhe para njohurive të nxënësit nga mësimdhënësi, krahas moshës dhe zhvillimit të tyre. Mësimdhënësi si ekspert i lëndës, duhet të zbatojë metoda që avancojnë aftësinë e nxënësit, që ai të jetë i pavarur në shprehje të mendimeve, të kenë mendim kritik të situatave letrare, të përzgjedhë për lexim literaturë që u pëlqen, sepse, çdo vepër e artit letrar, përmban mendime, ndjenja, kulturë, eksperiencë dhe kështu, bëhet si një mjet komunikimi vepër-lexues. Këtë lloj komunikimi me veprën letrare, secili lexues,( në këtë rast nxënës), e bën sipas mënyrës së vet, varësisht nga talenti e pasioni i tij. Kështu që, objektivë esenciale e mësimdhënësit, gjatë orës së letërsisë, duhet të jetë krijimi i rrugës sa më origjinale të komunikimit, në mes të nxënësit dhe njësisë letrare-estetike Pa

nivel të duhur të mësimdhënies, nuk mund të thuhet, se një mësimdhënës i organizon dhe i realizon objektivat e caktuar të një ore mësimore letrare. Formimi i vet mësimdhënësit, bindjet e tij dhe karakteristikat e personalitetit, janë elemente domethënëse, që krahas tekstit letrar, përcaktojnë në një mënyrë, arritjet e kompetencave mësimore të nxënësve. Nga personaliteti dhe formimi intelektual e profesional i mësimdhënësit, varet se çfarë konsideron ai thelbësore dhe primare në një njësi letrare, ose në një orë mësimore, apo çka konsideron ai dytësore e çka anësore. P.sh., në interpretimin e veprimtarisë së Gjon Buzukut, mësimdhënësi duhet të përqendrohet në faktin se ai është autori i librit të parë në shqip, se ai libër quhet “Meshari” dhe se është i botuar më 1555, pastaj të merret me dimensionet e tjera të shkrimit të tij, si atë lingistik, kulturor, diskursiv etj., që janë me një rëndësi më të vogël. Kjo nuk do të thotë që, mësimdhënësi duhet t’u shmanget fakteve periferike ose të dorës së dytë, por të dijë të ketë qasje të drejtë, në dhënien e informacionit sipas rëndësisë së tij. Në këtë aspekt, zhvillimi dhe përsosja e mjeshhtërisë së mësimdhënies, është një proces i vazhdueshëm, ngase ndryshon vazhdimisht edhe vetë realiteti jetësor e profesional. Prandaj, mësimdhënia si një proces i përgjithshëm, është shumë më komplekse dhe më e ndërlikuar, sesa mendohet. “Ajo sa është shkencë, po aq është edhe art”, (Bardhyl Musai, “Mjeshhtëritë themelore të mësimdhënies”, Tiranë, 2008, f. 28), sepse, krahas dijes shkencore profesionale, që mësimdhënësi duhet ta zotërojë, duhet të ketë edhe vlera të tjera kreative si; frymëzim, intuitë, talent, fleksibilitet dhe të tjera, që e bëjnë personalitet qendror (profesional) në klasë dhe në shkollë. Mësimdhënësi i letërsisë, duke i poseduar këto vlera, nuk nënkupton një

mësimdhënie të ngurtë, formale e artificiale, por një strategji të një mësimdhënieje natyrale, kreative, me metoda që lënë hapësirë edhe për interaktivitet, ndërhyrje e plotësime, pa i shkaktuar fëmijës ngarkesë monotone e ligjërim formal dhe në mënyrë që nxënësi, përmes aktivizimit në klasë, të aftësohet për ta dalluar të bukurën nga jo e bukura dhe artistiken nga e rëndomta, e pastaj edhe për ta dashur e krijuar atë. Aristoteli tek “Poetika” thotë: “Nxënësi që arrin të edukohet e të hetojë cilësinë artistike, nuk mund të kalojë indiferent as ndaj ylberit, as ndaj diellit, as ndaj shiut dhe as ndaj peizazheve të bukura...” (Grup autorësh , “Pedagogjia”, Zagreb, 1978, f. 197).

Si veçanti e mësimdhënies së letërsisë, është fakti se nxënësit duhet t,i qasemi në mënyrë shumë individuale, sepse arti gjithnjë përjetohet në mënyrë shumë subjektive, unikale. Këtu nuk kemi të bëjmë me seri emocionesh (apo me saktësi si në fizikë a matematikë), për fushën a artit, në këtë rast, të artit letrar, por secili ka prirjet e veta, që të përjetojë atë që i pëlqen dhe në këtë është shumë përcaktuese , komponentja emocionale e psikike, si rezultat i zhvillimit psiko-fizik dhe social të nxënësve. (Studimet psikologjike, tregojnë për unikalitetin psiko-emocional të fëmijëve, zhvillimi i të cilëve varet nga shumë faktorë të jashtëm të zhvillimit, siç janë: familja, rrethi ku jeton, shkolla, mësuesi, shoqëria, etj.) Pra, arti letrar, ndikon edhe në aspektin psikologjik të personalitetit të fëmijës, nga ai përfiton njohuri prej situatave dhe karaktereve psikologjike, të përmbajtjeve letrare, por krahas kësaj edhe nga metoda e mësimdhënies që e realizon mësuesi. Ai, duhet të posedojë patjetër njohuri profesionale dhe përmbajtjesore, të pjesës letrare dhe të reflektojë për domethënien, strukturën, natyrën e tekstit (përshkrim, rrëfim,

shpjegim, shpërthim ndjenjash, monolog apo dialog, apo mund të jetë një solucion artistik i shumë natyrave të shkruara më lart). Mësuesi i letërsisë, duhet të deshifrojë në mënyrë detale, bukurinë gjuhësore dhe estetike të një esence letrare. Duhet të dijë që, krahas analizës së saj, të vërë në funksion mënyra të aktivizimit të mendimit kritik të nxënësve përmes pyetjeve, me ç'rast kërkohet një analizë më e thellë e situatës, apo angazhim i imagjinatës së tyre, duke kërkuar nga ata të mendojnë, se çfarë kishin bërë vetë, në situata të tilla, apo si do të bëhej një zgjidhje më ndryshe, se ajo që ka bërë shkrimtari, në ndonjë situatë letrare-estetike. Metodë tjetër efektive dhe që zgjon kureshtjen e nxënësit, është edhe ajo, përmes së cilës kërkohet nga mësuesi, të bëjë krahasim apo lidhshmëri në mes të situatës letrare, me përditshmërinë konkrete të fëmijëve dhe perspektiva e mendimit nga sot, duke rezultuar asociacione të ndryshme, kreative e interaktive me nxënësit. Reflektimi i shumanshëm rreth një esence estetike-letrare, nga ana e mësimitdhënësit, reflekton parimet dhe teknikat e veta metodologjiko-didaktike:

- Të revokosh një shikim të përgjithshëm të çështjeve estetike të pjesës letrare;
- Të shqyrtosh çështje që çojnë deri te “ndriçimi” i çështjeve më dytësore;
- Të përfundosh një analizë interaktive të tekstit, për të shpjeguar edhe probleme të veçanta.

Është shumë i rëndësishëm, përqendrimi i mësuesit, në kultivimin e mundësisë për vrojtje, hetim të së bukurës, të nxënësit, e që kjo të shndërrohet në vetëdije të qëllimshme, për të bukurën. Kurse,



në shkollat tona, të shumtën, estetikja mësohet si një lloj edukate qytetare, e mërzitshme dhe monotone, kurse arti letrar, shpjegohet zakonisht nga aspekti biografik i shkrimtarit, koha kur është shkruar, ku dhe në çfarë rrethana socio-historike dhe politike. E vetëm formalisht, apo tepër pak, i kushtohet vëmendje, shpjegimit të aspektit gjuhësor, stilistik dhe estetik. Kurse nga nxënësit, kërkohen njohuri shumë formale dhe jo esenciale për vlerën letrare, sepse shumë mësimitdhënës, kanë më tepër prirje të bëjnë një analizë nga aspekti sociologjik, ideologjik e historik, të përmbajtjes, sesa të merren me aspektin estetik të saj. Për disa mësues, cilësia dhe rëndësia e ideve të përmbajtjes letrare, përcakton edhe vlerën estetike të saj dhe të krijimtarisë së autorit si tërësi, ndërkaq shumë aspekte të vlerës estetike të veprës së tij, mbesin jashtë orbitës së mësimitdhënies.

Një pjesë e madhe e mësimitdhënësve të tanishëm, konsiderojnë që, letërsia patjetër duhet të jetë edukative në aspektin social-etik-moral dhe vetëm nëse është e tillë, mund të ketë edhe vlera estetike. (Kjo ndodh edhe nga fakti se, shumë mësimitdhënës të letërsisë, janë të formuar profesionalisht dhe si analistë të letërsisë, në vitet e 70-ta, të 80-ta, kur gjithçka, edhe arti, ishte e përcaktuar nga aspekti i dobisë morale, etike e ideologjike). Për këtë, shpesh vlerat e larta estetike, binin si “viktimë” e mungesës së elementit ideologjik dhe me to mësimitdhënësi merrej shumë shkurt dhe atë në mënyrë shumë shkollore e të thjeshtë, për t’u preokupuar tërësisht me anën përmbajtjesore. Kjo do të thotë, se qasja estetike, ndaj veprës letrare, u mungon shumë mësimitdhënësve të shkollave tona dhe problematikë kryesore e mësimitdhënies së letërsisë, është qasja joadekuate e tyre, ndaj objektit letrar ose heshtja e aspektit estetik, kurse nga ana tjetër,

prania e analizës së vlerës letrare, gjithnjë nga aspekti historik, social e pedagogjik.

Përpjekjet që janë bërë, për reforma profesionale të mësimdhënies, shumë prej tyre, janë formale dhe më shumë teknike, sesa esenciale, përmbajtjesore e metodologjike .Në shkollat tona, mësohet letërsia, por nuk kultivohet shija artistike, nuk nxitet imagjinata krijuese e nxënësve. Që të profesionalizohet puna e mësimdhënësve të letërsisë, duhet aplikuar rrugë dhe metoda të përshtatshme, për përvetësimin e dijeve letrare-estetike nga ana e mësimdhënësve. Sepse ata, mund ta njohin shumë mirë letërsinë, por nuk mund të realizojnë asgjë, përmes mësimdhënies, nëse nuk e njohin metodikën e letërsisë ( me metodë kuptojmë një sistem parimesh, kriteresh dhe rregullash të caktuara, që zbatohen në një fushë dhe shërbejnë si mjet, për të arritur deri tek objektiva mësimore). Metodika përmban, mënyrat përmes së cilave, gjatë procesit të mësimdhënies, mësuesi i letërsisë u jep dituri nxënësve, i kontrollon ata, i vlerëson, i aftëson për punë të pavarur, për të shprehur mendim analitik e kritik, për të arritur deri tek aftësimi i tyre që, përmes shijes estetike të kultivuar, të dinë të përqendrohen në mënyrë të drejtë, në objektin estetik, të dinë të dallojnë vetitë e tyre, të hyjnë në debat me mësuesit e me shokët, si dhe të japin argumentet dhe konkluzionet e veta lidhur me vlerën letrare. “Duhet zgjuar kureshtjen, nevojën dhe dëshirën e nxënësve, për të lexuar, jo vetëm atë që është e shkruar, por edhe atë që nuk është e shkruar, që është e thënë në mënyrë figurative”, Grup autorësh, “Letërsi në shkollë”, Tiranë, 2001, f. 22). Përmes metodave adekuate të mësimdhënies së letërsisë, bëhet më i pranueshëm komunikimi; vlerë letrare-mësues-nxënës. Mësimdhënia e letërsisë, është një

proces i organizuar, që duhet të përshtatet e të lidhet ngushtë, me natyrën e lëndës, me specifikat, përmbajtjet dhe qëllimet e saj.

Bashkëpunimi me shkollat, na ka mundësuar të vijmë deri tek konstatimi, që është shumë e shprehur nevoja për aftësim profesional lëndor, i mësimdhënies së fushave të arteve e posaçërisht i mësimdhënies së letërsisë, që do të rezultonte me risi interpretimi e këndvështrimi si dhe qasje më bashkëkohore ndaj njësisë letrare-artistike, në mënyrë që të evitohen mënyrat tradicionale të realizimit të orës së artit letrar ( të tipit me recitime, lexime të referateve përshkruese të lektorës shkollore, e komentime të thjeshta të përmbajtjes letrare, duke anashkaluar zhvillimin e mendimit kritik e analitik të nxënësit lidhur me njësinë si dhe analizimin e saj edhe nga aspekti stilistik e estetik, varësisht nga moshja e tij. Sepse, detyrë morale, profesionale e intelektuale, e mësuesit të letërsisë është, krijimi i lexuesit-fëmijë, qysh në shkollimin fillestar, në mënyrë që më vonë, të kemi lexues të rritur në shoqëri).

#### **4.3.2. Teksti shkollor i letërsisë**

Roli i tekstit në procesin tonë edukativo-arsimor, është kyç dhe i pazëvendësueshëm (me gjithë burimet e tjera alternative të njohurive). Për këtë, nuk mund të imagjinohet një orë e suksesshme mësimore, pa një tekst cilësor dhe profesional, sepse teksti, përveç vlerës informative, përmbajtjesore, në një mënyrë, është edhe urë lidhëse, ndërmjet nxënësit dhe mësimdhënësit, e në anën tjetër edhe në mes të shkollës dhe dijes së përgjithshme

(në këtë kontekst, dijes letrare), duke dhënë edhe nxitjen për zhvillimin e njohurive të lëndës.

Cilësia e tekstit shkollor të letërsisë (dhe të çdo lënde) është parakusht i cilësisë së dijeve të nxënësve dhe kulturës së përgjithshme të tyre, si dhe është faktor që ndikon drejtpërdrejt në formimin letrar të nxënësve. Kurse, përmbajtja e një njësie letrare, në cilindo nivel shkollor qoftë, krahas qasjes dhe thellësisë interpretuese të mësimdhënësit dhe invencionit të tij shpjegues, është një element thelbësor që ndikon në edukimin estetiko-letrar dhe në kultivimin e dëshirës së nxënësve ndaj letërsisë, si njëra ndër artet kryesore. “Përmbajtjet letrare, kanë rëndësi të dorës së parë, duke ndikuar në formimin e arsyes, ndjenjave dhe mozaikut shpirtëror e kulturor të nxënësit”. (Bardhyl Musai, “Metodologjia e mësimdhënies”, Tiranë, 2003, f. 112) Prandaj, rëndësia e librave të letërsisë, në formimin e fëmijës-nxënësit, si qenie e gjithanshme intelektuale, ka qenë që nga lindja e letërsisë, e deri në kohët moderne, kur ka filluar që ky rol i ndikimit, të marrë trajtë edhe institucionale, duke u projektuar në formë plani e programi mësimor për shkollat. “Kështu që letërsia, është pjesë e rëndësishme e programit shkollor, për avancimin e edukimit të pjesëtarëve të shoqërisë”- (Instituti Albanologjik, “Letërsia në shkolla dhe në fakultete”, Prishtinë 2008, f. 106). Letërsia shkollore, misionin e vet estetik ndaj nxënësve, e realizon përmes përmbajtjeve letrare që performon dhe si qëllim e ka arritjen e këtyre kompetencave të nxënësit:

- Zhvillimin e aftësive për të përjetuar të bukurën;
- Zbulimin e vlerave estetike, etike, përjetimin dhe krijimin e tyre;

- Zhvillimin e kulturës së të shprehurit;
- Zhvillimin e aktiviteteve mendore dhe aftësive të punës krijuese. (Nuhi Rexhepi, “Letërsia në tekstet shkollore të Kosovës 1945-1990”, Prishtinë 2002, f. 31)

Ndërkaq teksti shkollor i letërsisë, duhet të përpilohet sipas kriterëve profesionale: kriterit estetik, përmbajtjesor, të përshtatshmërisë me moshën, të aparaturës didaktike (harmonizimit të pyetjeve, detyrave, ilustrimeve, komenteve, fjalorit - fjalëve të panjohura etj). Edhe sipas dokumentit të MASHT-it “Strategjia për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë 2007-2017” përgatitja e teksteve shkollore dhe e materialeve didaktike cilësore, llogaritet si masa prioritare, e cila do të sigurojë arritjen e objektivave të veçanta e të përgjithshme arsimore, (“Strategjia për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë 2007-2017”, MASHT- Prishtinë – 2007, f. 73)sipas së cilave janë hartuar edhe standardet për përpilimin e teksteve shkollore. Në bazë të këtyre standardeve teksti shkollor duhet të përmbushë 15 standarde të përgjithshme, të cilat janë të seleksionuara në 4 aspekte:

1. Aspekte formale ( paraqitja, pamja);
2. Aspekte metodike dhe didaktike;
3. Aspekte pedagogjike;
4. Aspekte lidhur me praktikën (me kurrikulën, realitetin shoqëror etj) (“Standarde për tekste shkollore”, MASHT – Prishtinë, 2011, f. 7)

Pastaj janë edhe standardet specifike për lëndët e caktuara dhe secili prej tyre i ka treguesit e vet. Disa standarde të veçanta të librit shkollor të letërsisë janë:

- Të kontribuojë në zhvillimin e një kulture të të lexuarit në vazhdimës;
- Të përmbajë një spektër të gjerë të llojeve të teksteve letrare;
- Të përmbajë udhëzime në lidhje me aspektet teknike të leximit dhe mënyrat si duhet punuar me lloje tekstesh të caktuara (poezi, prozë, tekst informativ etj.);
- Të përzgjidhen tekste, përmes së cilave nxënësit të mësohen për modalitete të ndryshme të leximit (lexim informativ, lexim zbavitës, lexim interpretues, lexim kritik);
- Të përmbajë zgjedhje cilësore, të përshtatura me moshën e nxënësve, me shembuj nga letërsia e popullit të vet, duke kontribuar në formimin dhe edukimin letrar në gjuhën dhe kulturën e tij;
- Të përmbajë shembuj dhe vlera estetike nga popujt dhe kulturat e tjera. (“Standarde për tekste shkollore”, MASHT – Prishtinë, 2011, f. 7)

“Detyrë themelore e çdo lënde mësimore është arritja e një qëllimi, prandaj teksti duhet përshtatur me këtë qëllim”. (Fransua-Mari zherar, Ksavje Rozhje, “Hartimi dhe vlerësimi i teksteve shkollore”, f. 72 ) Teksti shkollor në këtë kontekst është faktor kryesor që ndikon në arritjen e objektivës arsimore (edukimit estetik në këtë rast), të cilit i referohet mësimdhënësi, nga i cili

nxjerr informacionin letrar dhe idetë, për t'ua interpretuar nxënësve, në mënyrë sa më profesionale që nxënësi të bëhet një subjekt estetik, gjithnjë duke i respektuar mundësitë receptuese, përjetuese e njohëse në komunikimin artistik të tij.

### **4.3.3. Lektyra shkollore**

Mësimi i letërsisë në shkolla dhe jashtë saj, kërkon (siç ka ndodhur gjithnjë gjatë zhvillimit shoqëror) harmonizimin me kërkesat që ofron jeta sot dhe zhvillimet shoqërore, ekonomike, teknologjike e kulturore. Pra, edhe mësimi i letërsisë, si çdo aspekt tjetër i mësimin dhe i jetës, kërkon ndryshimin dhe modernizimin e vet. Në kuadër të kësaj, duhet modernizuar e ndryshuar edhe krijimtaria letrare për fëmijë, tekstet shkollore të letërsisë, por edhe lista e lekturës letrare shkollore, që u ofrohet për ta lexuar nxënësve të arsimit parauniversitar përgjithësisht. Lektyra, e cila për sa kohë u ofrohet nxënësve të shkollave tona, është si e konservuar dhe me decenie e pandryshuar, apo vetëm e reduktuar, duke ia shkëputur librat ideologjikë që ka pasur më herët (sidomos ato të pasluftës së Dytë Botërore dhe të kohës së ndërtimit socialist, si: romani “Kënetë”, “Lumi i vdekur”, “Fshati midis ujerave”, “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”, “Njerëzit” etj). Mirëpo, edhe ata që kanë hyrë në listë të lekturës shkollore, disa nuk janë adekuatë me moshën e nxënësve që u është caktuar ta lexojnë, e disa nuk janë vlerësuar nga asnjë lloj kritike, për vlerën e tyre estetike, për të cilën edhe është i dedikuar arti letrar në shkollë.. Marrë përgjithësisht, lista e lekturës shkollore jo për vite, por për decenie të tëra, është e pa përtërirë për nga

përmbajtja e saj dhe e papërshtatur në disa raste me moshën, në disa raste me kohën, e në shumë raste edhe me vlerën estetike që është si objektive e lëndës së letërsisë. Mangësi tjetër e lektyrës shkollore është, mospërfshirja e duhur e letërsisë botërore. Lista e lektyrës shkollore për klasat VI, VII, VIII, IX, prej 30 titujve që përmban, vetëm gjashtë janë letërsi e huaj. Kurse, krahas zhvillimeve të përgjithshmeve dhe ndryshimeve të çdo aspekti jetësor dhe krijimit të mundësive e alternativave të komunikimit, të përfitimit të njohurive të përgjithshme, të kontaktit edhe me arte të të gjitha llojeve, edhe të atij letrar, përmes formave të avancuara teknologjike-informative, është krijuar edhe mundësia e kompensimit të leximit të librave letrarë. Kështu që edhe përpiluesit e programeve mësimore, në veçanti ata të planifikimit të lektyrës shkollore, duhet të respektojnë, përveç kritereve të tjera edhe atë të ndryshimeve të kohës, në mënyrë që të mos mbeten prapa kërkesave bashkëkohore të shijes së nxënësve. Vetë natyra e fëmijës, përmban aftësi-shkathësi dhe kureshtje gjithnjë të zgjuar për të perceptuar ndryshimet e çdo aspekti, e në këtë kontekst, të teknologjisë informative, të cilave ata u adaptohen dhe i aplikojnë më shpejt e më me sukses sesa të rriturit. Ky fakt patjetër që kushtëzon përshtatjen edhe të teksteve të letërsisë edhe të lektyrës shkollore, me kohën dhe kërkesat e nxënësve, në mënyrë që ajo të mos jetë jo interesante dhe të tejkaluara, gjë që mund t'ua shkaktojë nxënësve monotoni, mosinteresim dhe përfundimisht të rezultojë me kundër-efekt. D.m.th. të mos ndodhë që, në vend se letërsia e ofruar përmes lektyrës shkollore, t'ua ofrojë nxënësve kënaqësi emocionale, përjetim artistik, e avancim të shijes estetike, ajo në rast të mospërshtatjes me kohën e me preokupimet e nxënësve, mund të shkaktojë iritim e humbje



të interesimit për të. P.sh. një gjë të tillë, mund të shkaktojë edhe vepra “Albumi” e Nolit e cila është vendosur në lektyrën obliguese të klasës VII-të, kur akoma nuk janë të avancuara aftësitë perceptuese të nxënësve për të deshifruar artin letrar, me përmbajtje siç është “Albumi” e me figuracion krejtësisht politik, social, filobiblik, e filozofik. Të gjitha poezitë e kësaj përmbledhjeje, që nga titujt: “Marshi i Krishtit”, “Marshi i barabajt”, “Krishti me kamgjik”, “Shën Pjetri në mangall”, “Tamsoni e kuçedra”, “Sofokliu”, “Marshi i kryqëzimit”, etj., kanë figuracion filo-biblik, kishtar dhe përmbajtje e aludime politike e sociale, të kohës. Për ta kuptuar simbolikën e këtyre poezive, lexuesi i saj, duhet pasur një bagazh të tërë paranjohurish të gjithanshme, intelektuale, politike, historike, kishtarë, filozofike, etj. Një nxënës 13-14 vjeç, tepër pak nga këto paranjohuri, mund t’i ketë. Qoftë edhe me ndihmën e mësimdhënësit, deshifrimi e kuptimi i këtyre poezive, nuk është diç që fëmijës mund t’i interesojë shumë, apo që mund ta gjejë veten aty në mënyrë që ta përjetojë, ta dojë e ta mbajë mend .

Kjo vepër u potencua vetëm si shembull më bindës, për mos përshtatjen e natyrës së artit dhe përmbajtjes letrare me moshën dhe parapërgatitjen e lexuesit-nxënës, 13-14 vjeç, e kurrsesi jo, për të kontestuar cilësinë e shumanshme e të pakontestueshme që ka autori dhe kjo vepër e tij. Ky është edhe një shembull për të theksuar që, duhet shumë profesionalizëm në përpilim të gjithë programit arsimor, qoftë edhe të një dimensionimi më të ngushtë, siç është lektyra shkollore. Mjetet e komunikimit masiv (televizioni, kompjuteri-interneti, mediat) dedikuar fëmijëve, janë mjete shumë dinamike informative dhe faktorë me ndikim të

fuqishëm në edukimin dhe arsimimin e përgjithshëm të nxënësit. Pra edhe këto, janë si burime të krijimit e zhvillimit të shijes estetike të fëmijëve - të rinjve, prandaj duhet pasur parasysh këtë fakt, që është një konkurrent dominant, krahas edukimit estetik në shkollë, në mënyrë që të përzgjidhen përmbajtje adekuatë për interesimin dhe kureshtjen e fëmijës - nxënësit. Lista e mëposhtme e lekturës letrare, është lista aktuale (që aplikohet tani), e marrë nga disa shkolla në Prishtinë dhe jashtë saj. Dhe, shikuar përgjithësisht, kjo listë e lekturës shkollore, jo se nuk performon vlera të letërsisë shqiptare dhe asaj botërore, por duke pasur parasysh zhvillimet shoqërore në çdo aspekt, në shumë raste nuk zgjon shumë interesim të nxënësit, kurse disa tituj (“Albumi”, “Andrra e jetës”, “Njëqind vjet vetmi”) edhe janë jashtë kapaciteteve deshifruese të artit letrar, që posedon fëmija i moshës 13-14-vjeçar, në këtë rast nxënësit e klasës së shtatë, të cilëve u janë dedikuar këto vepra. Po ashtu, lektura e klasës së nëntë (për fëmijët e moshës 15-16 vjeç), përmban tituj që janë jashtë kapaciteteve perceptuese të nxënësve për aspektin artistik e përmbajtjesor të veprës letrare. Kështu, mund të themi që kriteret e përzgjedhjes së veprave letrare si lekturë shkollore, janë jo shumë profesionale dhe në mënyrë të veçantë, neglizhohet kriteri i nivelit të zhvillimit psiko-fizik, emocional dhe intelektual i nxënësve.

Kjo është lista e lekturës shkollore, që aplikohet në shumë shkolla;

### **Lektura për klasën e gjashtë**

1. “Tregime të moçme shqiptare” - Mitrush Kuteli

2. “Luli i vocërr” - Migjeni
3. “Zogu dhe kulla” - Rrahman Dedaj
4. “Poezia të zgjedhura” - Ymer Shkreli
5. “Sarajet e bardha” - Vehbi Kikaj
6. “Tom Sojeri” - Mark Tuen
7. “Nita” - Josip Re

### **Lektyra për klasën e shtatë**

1. “Njëqind vjet vetmi” - Sabri Hamiti
2. “Albumi” - Fan Noli
3. “Trimi i mirë me shokë shumë” - Sylejman Pitarka
4. “Robinson Kruso” - Daniell Defo
5. “Përtej largësive” - Bilall Xhaferi
6. “Kush do ta vrasë ujkun” - Ali Podrimja
7. “Andrra e jetës” - Ndre Mjeda
8. “Zemra” - Edmond de Amiçis

### **Lektyra për klasën e tetë**

1. “Lulet” - Naim Frashëri
2. “Juda makave” - Gjergj Fishta
3. “Poezi” - Ali Podrimja

4. “Lutjet e mbrëmjes” - Anton Pashku
5. “Malësorja” - Nazmi Rrahmani
6. “Udhëtim arbdhetar”- Zejnullah Rrahmani

### **Lektyra për klasën e nëntë**

1. “Plaku dhe deti” - Ernest Heminguei
2. “Iliada e Odiseu” - Homeri
3. “Besa” - Sami Frashëri
4. “Lirikat e vjeshtës” - Dritëro Agolli
5. “Juvenilia” - Ndre Mjeda
6. “Eneida” - Virgjili
7. “Dhembja e pikës” - Azem Shkreli
8. “Lulet e së keqes” - Charl Bodler
9. “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet” - Sami Frashëri

Pavarësisht veprave letrare, aspekti i edukimit estetik përmes letërsisë, është një çështje e cila, nuk mund të matet as të përshkruhet, sepse ndikimi estetik lind aty për aty, mbi bazën e shkallës së komunikimit në mes të lexuesit (nxënësit në këtë rast) me tekstin letrar, i cili në rrethana normale artistike, ka synim kryesor estetiken. Ky komunikim – përjetim, është shumë individual, saqë asgjë në këtë aspekt, nuk mund të përgjithësohet

dhe është i përcaktuar nga para kultura e lexuesit-nxënësit dhe nga aftësitë e gjenialitetit e origjinalitetit krijues të autorit, nga talenti ekzibicional imagjnativ, semiotik, struktural, etj. i tij. Letërsia si e tillë, me potencial ngacmues artistik të emocionit, nxit perceptimin, gjykimin dhe zgjon përjetimin estetik. Përjetimi estetik, ndjenja estetike, stimulon qëndrimin krijues dhe estetik jo vetëm ndaj artit, por edhe ndaj realitetit përgjithësisht. Ndjenja estetike, sado që është subjektive, njëkohësisht ka edhe karakter shoqëror, sepse ndjenjat dhe shijen estetike në një masë i posedojnë të gjithë. Arti si krijimtari, përveç vlerës artistike-estetike, posedon edhe dobi historike, psikologjike e sociale, sepse lidhet direkt me vlerën e vlerave të shoqërisë. Çështje tjetër është fenomeni i avancimit, përsosjes së saj (shijes), përmes metodave të edukimit-arsimimit, me qëllim që njerëzit ta bëjnë sa më shumë e sa më mirë atë që është më e dobishme, më e përsosur e më e bukur në jetë. Një problematikë më vete, do të ishte, raporti në mes të artit e shoqërisë, përderisa në këtë kontekst, e kemi raportin në mes të artit letrar dhe nxënësve. Edukimi estetik i nxënësve, nuk është ndonjë aktivitet i veçantë edukativ, ky aspekt i edukimit në shkollë, realizohet përmes shumë lëndëve e fushave mësimore dhe përmes shumë aktiviteteve të lira kulturore, por letërsia është art, që përveç pasionit, ka edhe mendimin i cili përmes saj, transmetohet tek nxënësit për plot arsye, e të cilat janë cekur shumë herë, më lart.

## V. PËRFUNDIM

Shkalla me e lartë e performancës së shijeve të shëndosha estetike dhe kulturës së formuar mirë është krijimi i stilit estetik të jetës, ngase e bukura përfaqëson të përkryerën në të gjitha fushat e jetës e të natyrës. Ajo na ngjall në shpirt ndjenja të pafundme kënaqësie, sepse . njeriu prej natyrës, është i prirë për të bukurën dhe krahas të të jetuarit, gjithnjë bën përpjekje për ta krijuar të bukurën në jetë, në mjedisin ku jeton dhe në mjedisin shoqëror që e ndërton. Do të ishte ideale, që te njeriu të ishte gjithçka e bukur: edhe dukja, edhe shpirti, edhe mendja, edhe veprat, edhe raportet dhe të gjithat që e përbejnë jetën e tij. Për këtë, ky lloj edukimi duhet të fillojë te njeriu, që në fëmijërinë e hershme të tij, që në familje, për të vazhduar pastaj në mënyrë të sistemuar e institucionale në shkolla, përmes lëndëve të natyrës artistike e posaçërisht përmes letërsisë. Rëndësia esenciale e edukimit estetik për fisnikërimin dhe qytetërimin e njeriut e shoqërisë në përgjithësi dhe fakti që jemi duke e përjetuar “statusin” e brishtë të vlerave estetike në shoqërinë tonë e në shkollat tona, në mënyrë të veçantë, ka bërë që kjo çështje të jetë objekt i këtij studimi.

Gjatë konsultimit me literaturën adekuate për çështjen, shohim se lidhur me këtë problematikë studimi, kanë thënë shumë filozofët, që nga Platoni e Aristoteli, për të vazhduar deri te Kanti, Frojdi, Shileri, Lalo, Uçi, etj. Kështu që, ne nuk mund të themi diçka të re për rëndësinë e edukimit estetik (në aspektin shkollor e

jetësor), por e rikonfirmojmë rëndësinë e edukimit estetik në kuadër të sistemit edukativo-arsimor të çdo shoqërie.

Zhvillimet shoqërore, ekonomike, teknologjike e kulturore, kushtëzojnë ndryshimin edhe të çdo aspekti tjetër jetësor. Në këtë kohë ndryshimesh të mënyrës së jetesës, në mes të modernizimit të pakontrolluar të çdo aspekti , edukimi estetik, ndoshta do të ishte forma më efikase që do të ndikonte në formimin më të drejtë të njeriut tonë të ri. Pra, shtohet nevoja për angazhimin e të gjitha llojeve të pedagogjisë, e edhe asaj letrare për t'ia përshtatur vetëdijes, ndërgjegjes dhe zhvillimit të botëkuptimit tonë, shpirtëror e kulturor. (Kadare në një intervistë thotë: “Shqiptarët sot kanë nevojë më shumë se kurrë për një rilindje morale, sepse edukata shpirtërore, kulturore, personale, është baza nga e cila zhvillohet gjithçka tutje”).

Lidhur me këtë dimension edukimi, edhe disa nga analizat empirike në shkollë, arrijmë te konstatimet që edukimi estetik, e letërsia si art i veçantë edukativo-pedagogjik, me gjithë vlerën e pazëvendësueshme që ka për fisnikërimin shpirtëror, emocional e jetësor në përgjithësi, nuk trajtohet në mënyrë të mirëfilltë, që nga familja, mësuesi, institucionet shkollore, politika arsimore dhe shoqëria. Ky fakt, mund të shkaktojë mungesën e lexuesve fëmijë, demotivimin e krijuesve të letërsisë për fëmijë dhe neglizhencën e kritikës letrare ndaj kësaj letërsie. Mos leximi i letërsisë, shkakton mangësi të pakompensueshme në formimin e personalitetit më të plotë të fëmijës-nxënësit dhe në perspektivën më fisnikëruese të shoqërisë. Në librat letrarë, fëmija ka të pasqyruar në mënyrë të thjeshtë e reale (konform kapaciteteve të tyre perceptuese) situata jetësore nga më të ndryshmet, me

kompleksitetin e tyre, të cilat edhe po të jetonte njeriu me shekuj, nuk do të mund t'i haste. Këto situata jetësore-letrare, e forcojnë, e pjekin fëmijën, e parapërgatitin për jetën, vështirësitë dhe sfidat që mund t'i ketë ai. Mungesa e edukimit estetik të nxënësit-fëmijës, moskultivimi e moskrijimi i shijes së tyre për ta vërejtur, për ta dashur e edhe për ta krijuar të bukurën, pason me indiferencën e tyre ndaj së bukurës përgjithësisht, në punë, në jetë, si dhe në indiferencën edhe ndaj etikës e morales, të cilat janë disa ndër qëllimet e letërsisë për fëmijë. Prandaj, në mungesë të edukimit estetik, e brenda këtij edhe edukimit etik e moral (këto kategori-moralen e etiken, nuk i kanë ndarë plot filozofë dhe estetë botërorë), pasojnë çrregullime esenciale të personalitetit të fëmijës, ai pastaj mund të orientohet kah fenomenet degjeneruese, që shpijnë deri tek indiferenca dhe devijimet e natyrave të ndryshme, të cilat i shohim me të madhe, në përditshmërinë e familjes, shkollës dhe shoqërisë sonë.

Kjo ndodh sepse, në kohën tonë, si çdo gjë tjetër, janë politizuar e komercializuar edhe arti letrar dhe tekstet shkollore. Kjo ka bërë që të kemi lexues të paformuar, që lexuesit t'i dëmtohet e t'i prishet edhe shija e tij, dhe të dëmtohet edhe kultura shoqërore në përgjithësi. Nuk ka më shumë dhunti, për krijim, sa ka dhunti, për përfitim material. Materializimi i gjithçkaje, komercializimi i jetës në tërësi, e i çdo aspekti të jetës në veçanti, e shtyjnë edhe nxënësin të mendojë, vetëm për anën materiale që i sjell dobi atij (d.m.th. obsesion nënkuptues, edhe nxënësit kanë kënaqësinë, pushtetin, paranë, etj.). Kështu, edhe shkolla është e fiksuar më shumë në treg të punës, duke e përforcuar edhe më tej këtë mjerim edukativ dhe estetik. Sepse, nxënësi formohet-rritet i kushtëzuar me idenë fikse, se gjithçka duhet t'i shërbejë diçkaje



tjetër dhe gjithësi të jetë e dobishme materialisht. Kjo shkakton mjerimin estetik, etik e shpirtëror, të shoqërisë. Në këtë situatë krizash, të shumanshme shoqërore, është tepër i rëndësishëm edukimi shpirtëror i nxënësve dhe ndërgjegjësimi i tyre përmes mënyrës më spontane, më sublime, përmes metodës së edukimit estetik (e artit letrar në veçanti), e cila është një mënyrë e veçantë, e këndshme, e thellë dhe e qëndrueshme e edukimit.

Kur është fjala për nivelin e edukimit estetik të fëmijëve-nxënësve (apo njerëzve të rinj) dhe të njeriut tonë në përgjithësi, rreziku më i madh është, te neglizhenca e këtij lloj edukimi, nga ana e kompetentëve tanë arsimorë, përderisa shkenca e pedagogjisë moderne, edukimin estetik nuk e sheh vetëm përbrenda kufijve të artit, por edhe jashtë tij, tek e bukura në natyrë, tek e bukura në shoqëri dhe në jetë përgjithësisht.

## VI. Bibliografia

1. Demiri, Qibrie, “Letërsia për fëmijë”, “Rozafa”, Prishtinë, 2011
2. Deva, Agim, “Poezia shqipe për fëmijë - 1872-1980”, “Rilindja”, Prishtinë, 1982
3. Dewey, John, “Shkolla dhe shoqëria”, Plejad, 2003, Tiranë
4. Eco, Umberto, “Si shkruaj”, AIKD, Prishtinë, 2003
5. Emërllahu, Dali, “Edukata estetike”, Prishtinë, 2001
6. Fraj, Northrop, “Anatomia e kritikës”, Rilindja, Prishtinë, 1990
7. Frojd, Zigmund, “Mbi letërsinë dhe artet”, F. Noli, Tiranë
8. Grup autorësh, “Letërsi në shkollë”, Tiranë, 2001
9. Grup autorësh, “Pedagogjia”, Zagreb, 1978
10. Grup autorësh, Instituti Albanologjik, “Letërsia në shkolla dhe në fakultete”, Prishtinë, 2008
11. Kant, Imanuel, “Kritika e gjykimit”, Plejad, 2002, Tiranë
12. Kumnova. M, Hyseni,M., “Leximi letrar 7”, Libri Shkollor, Prishtinë, 2010
13. Musai, Bardhyl, “Metodologjia e mësimdhënies”, Tiranë, 2003

14. Musai, Bardhyl, “Mjeshtëritë themelore të mësimdhënies”, Tiranë, 2008
15. Petro, Rita & Sylva, Xhevat, “Leximi Letrar 6”, Botime Shkollore, Prishtinë, 2004
16. Qosja, Rexhep, “Historia e Letërsisë shqipe III, Romantizmi, “Rilindja”, Prishtinë, 1986
17. Rexhepi, Nuhi, “Letërsia në tekstet shkollore të Kosovës”, Prishtinë, 2002
18. Rugova, Ibrahim, “Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983”, Prishtinë, 1983
19. “Strategjia për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë 2007-2017”, MASHT- 2007
20. Shiler, Fridrih, “Mbi edukimin estetik të njeriut”, Tiranë, 2004
21. Uçi, Alfred, “Universi Estetik”, Tiranë, 2007
22. Uçi, Alfred, “Estetika I-II-III”, Tiranë, 1986
23. Zherar, Mari, Fransua & Rozhje Ksavje, “Hartimi dhe vlerësimi i teksteve shkollore”
24. “Strategjia për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë 2007-2017”, MASHT- Prishtinë, 2007
25. “Standardet për tekstet shkollore”, MASHT, Prishtinë, 2011

## VII. Literatura:

- “Rrjedhat e letërsisë bashkëkohore shqiptare”, ASHAK, 2005
- “Strukturë për zhvillimin e mendimit kritik gjatë kurrikulumit” (Udhëzues nr. 1) KEC Prishtinë, 2001
- “Leximi shkrimi dhe diskutimi në çdo lëndë”, (Udhëzues nr. 3) KEC, Prishtinë, 2001
- Anica, Mikush Kos & bashkautorët, “Shkolla dhe shëndeti mental”, QPEA, 2010
- Biefler. F. Roberts, Jack Snoeman, “Psikologjia e zbatuar në mësimdhënie”, ISP “Nënë Tereza”, Tiranë, 2004
- Bryner, Jerome, “Kultura e edukimit”, ISP, Tiranë, 2003
- Çaush, Tefil, “Fjalor i estetikës”, ‘Onufri’, Tiranë, 1998
- Dedja, Bedri, “Sekreti i talentit”, ‘Toena’, Tiranë, 1998
- Dr. Susan, Lin: [www.parenting-qa.com](http://www.parenting-qa.com) (2011)
- Eko, Umberto, “Si bëhet një punim diplome”, ‘Përpjekja’, Tiranë, 1997
- Eshrefi, Isak, “Poetika e letërsisë sociale e viteve 30-ta”, Rilindja, Prishtinë, 1990
- Fraj, Northrop, “Anatomia e kritikës”, “Rilindja”, Prishtinë, 1990
- Fullan, Michael, “Forca e ndryshimit”, Tiranë, 1999.

- Fullan, Michael, “Kuptimi i ri i ndryshimit në arsim”, Tiranë, 2001.
- Gërliç, Danko, “Estetika- Historia e problemeve filozofike”, “Rilindja”, Prishtinë, 1986
- Grillo, Kozma, “Pedagogjia familjare”, Tiranë, 1988.
- Grillo, Kozma, “Fjalor edukimi”, (psikologji-sociologji-pedagogji) ISP, Tiranë, 2002
- Gjermani, Linda, “Prindërit dhe shkolla, miq të mundshëm”, Tiranë
- Kraja, Musa, “Pedagogjia”, Tiranë, 2006.
- Instituti i Studimeve Pedagogjike, “Hartimi dhe vlerësimi i teksteve shkollore”, Tiranë, 2003
- Jorgaçi, Nasho, “Antologji e mendimit estetik shqiptar 1504-1944”, “Dituria”, 2000
- Myller, Bonye, “Komunikimi me fëmijët”, Prishtinë, 2007.
- Osmani, Shefik, “Fjalori i Pedagogjisë”, “8 Nëntori”, Tiranë, 1983
- Pollak, Myra & Miller, David, “Mësuesit, shkolla dhe shoqëria”, Tiranë, 1994.
- Qosja, Rexhep, “Dialogje me Shkrimtarët”, ‘Rilindja’, Prishtinë, 1968
- QTKA, “Profesioni i mësuesit”, Tiranë, 2006

- Ramaj, Abdyl, “Formësimi didaktik i lëndës në tekstin mësimor”, Libri Shkollor, Prishtinë, 2001
- Raporti SMS; [www.physorg.com/NEWS\(2011\)](http://www.physorg.com/NEWS(2011))
- Rexhepagiqi, Jashar, “Tema të zgjedhura”, Prishtinë, 2002.
- Shema, Isak, “Vrojtime letrare dhe artistike”, Rilindja, Prishtinë, 1995
- Shoqata për ndihmë psiko-sociale, “Forcimi i fëmijëve në rrethana të vështira jetësore”, Zagreb, 2001
- Tevo & Lekomt, “Komenti Letrar”, “Eugen”, Tiranë, 2000
- Tufa, Agron, “Letërsia dhe procesi letrar në shekullin XX”, Libri universitar, Tiranë, 2009
- Vinca, Agim, “Alternativa letrare”, Shkup, 1995
- Woolfolk, Anita, “Psikologji edukimi”, Qendra Për Arsim Demokratik, Tiranë, 2011
- [www.nyc.gov/school](http://www.nyc.gov/school) (2011)
- Xhiku, Ali, “Nga romantizmi, rrjedhave të realizmit”, Tiranë, 1989
- Zuna, Afërdita & bashkautorët, “Partneriteti shkollë-familje-komunitet”, Prishtinë, 2009.
- Zhenet, Zherar, “Figura”, ‘Rilindja’, Prishtinë, 1985.

## **Botues**

Instituti Pedagogjik i Kosovës

## **Shtypi**

Shtypshkronja NTSH “Rilindja” Prishtinë

Tirazhi: 500 copë

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

37.036:82

Plakolli, Zehrie

Edukimi estetik i nxënësve dhe letërsia për fëmijë /  
Zehrie Plakolli. - Prishtinë: Instituti Pedagogjik i  
Kosovës, 2015. - 69 f. 21 cm.

Bibliografia: f.64

**ISBN 978-9951-591-23-2**